




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INTEGRIMIT

# Pasojat Ligjore të Marrëveshjes së Përkohshme Shqipëri - BE

*Manual për Gjyqësorin Shqiptar*





I nderuar lexues,

Nëshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian më 12 qershor 2006 që u cilësua si një ngjarje vendimtare në procesin e Integritimit Evropian u shoqërua disa muaj më vonë, më 1 dhjetor 2006 me një tjetër ngjarje të rëndësishme. Hyri në fuqi një pjesë e rëndësishme e MSA-së, Marrëveshja e Përkohëshme (*ad interim*).

Kjo Marrëveshje ka filluar të sjellë ndryshime të dukshme në regjimin doganor të Shqipërisë me vendet e BE-së dhe ka lehtësuar më tej zhvillimin e tregëtisë ndërmjet Palëve.

Por zbatimi me korrektësi i kësaj marrëveshje kërkon një shkallë të lartë informimi dhe profesionalizmi nga ana e administratës doganore. Ndërkohë që edhe gjykatat shqiptare duhet të jenë të përgatitura të trajtojnë çështjet që mund të lindin si pasojë e mosrespektimit të plotë të regjimit të ri doganor nga ana e autoriteteve shtetërore.

Ky botim synon t'u vijë në ndihmë gjykatave shqiptare dhe të ndikojë për zbatimin me korrektësi të Marrëveshjes së Përkohëshme, duke adresuar në këtë mënyrë edhe disa prej rekomandimeve më të rëndësishme të Komisionit Evropian për Shqipërinë, që lidhen me forcimin e kapaciteteve të administratës publike dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor.

Me këtë rast do të doja të falënderoja stafin e Ministrisë së Integritimit dhe ekspertët që mundësuan realizimin e këtij botimi, si dhe Ambasadën Britanike për mbështjen e vyer financiare.

**Majlinda BREGU**  
*Ministre e Integritimit*

*Pasojat Ligjore të Marrëveshjes së Përkohshme Shqipëri - BE*

*Autorët kryesorë:*

**Albert Meça**

**Gjergji Vurmo**


*Ministria e Integritit, Tiranë 2007*

## Fal ënderime

*Ky botim u përgatit nën kujdesin e Ministrisë së Integrimit të Republikës së Shqipërisë me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike në Tiranë.*

*Autorët u janë thellësisht mirënjohës për mbështetjen dhe konsulencën e dhënë nga ekspertët dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Integrimit dhe institucioneve të tjera shtetërore gjatë përgatitjes së këtij botimi. Në mënyrë të veçantë do të dëshironim të falenderonim Shkëlqesinë e Saj, Ministren e Integrimit Znj.Majlinda Bregu dhe Shkëlqesinë e Tij, Ambasadorin Britanik në Tiranë Z.Fraser Wilson për mbështetjen maksimale në këtë projekt.*


*Gjithashtu do të dëshironim të shprehim mirënjohjen për Z. Arben Kashahu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit, për mbështetjen e ofruar dhe Z. Klementin Mile për koordinimin e shkëlqyer të përgatitjeve në lidhje me këtë botim si edhe ekspertëve të tjerë për konsulencën dhe kontributin e vyer.*



# I. Hyrj e

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) vitin e shkuar dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme më 1 Dhjetor 2006 Shqipëria është futur tashmë në një marrëdhënie të re kontraktuale me Bashkimin Europian dhe rrjedhimisht, në një fazë të re të procesit të integritimit europian të vendit. MSA u nënshkrua më 12 Qershor 2006 - thuajse tre vjet pas hapjes zyrtare të negociatave (Janar 2003) - dhe aktualisht ndodhet në fazën e ratifikimit prej vendeve anëtare të Bashkimit. Duke pasur parasysh se procesi i ratifikimit të saj kërkon një periudhë kohore relativisht të gjatë (2 - 3 vjeçare), palët e marrëveshjes nënshkruan të ashtuquajturën Marrëveshje e Përkohshme (*Interim Agreement*) e cila fokusohet në krijimin e një zone të tregtisë së lirë me BE dhe kjo, para se MSA të hyjë në fuqi.<sup>1</sup> Pra Marrëveshja e Përkohshme (MP), e cila ndryshe nga MSA nuk kërkon ratifikimin e vendeve anëtare të BE, lehtëson fillimin e zbatimit të dispozitave të MSA që kanë të bëjnë me tregtinë dhe çështje të tjera të bashkëpunimit ekonomik midis Shqipërisë dhe BE. Kjo do të thotë se MP është praktikisht pjesë integrale e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, pavarësisht se ajo kalon nëpër të tjera procedura miratimi nga ato të MSA - dhe kjo në respekt të problematikës që rregullon (e cila është nën kompetencat komunitare të BE) si edhe të nevojës për thellimin e marrëdhënieve ekonomike mes palëve.

Marrëveshja e Përkohshme zëvendësohet me dispozitat e plota të MSA me hyrjen në fuqi të kësaj të fundit duke përmbyllur kështu plotësisht kuadrin ligjor e institucional të marrëdhënies së re kontraktuale me BE. Nga ana tjetër, MP përbën aktin pasues e zëvendësues të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Shqipërisë" e vitit 1992 midis vendit tonë dhe BE, e cila përveç disa


 <sup>1</sup> Ndërkohë që palët e MP janë Shqipëria dhe Komuniteti Europian (KE), në bazë të nenit 53 të MP zbatohet në territorin e Shqipërisë dhe në territorin e vendeve ku zbatohet Traktati i krijimit të Komunitetit Europian.

dispozitave të veçanta shfuqizohet plotësisht.<sup>2</sup> Sidoqoftë, lista e marrëveshjeve dhe akteve të tjera “të ndërthurura” me MP nuk përfundon këtu, por ajo përfshin (u referohet) edhe akte të tjera ndërkombëtare si Marrëveshja e GATT (1994), rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), Marrëveshja e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) apo edhe Traktati themelues i Komunitetit Europian (KE).

Ashtu si MSA, edhe Marrëveshja e Përkohshme nuk përmban vetëm detyrime ligjore që kanë të bëjnë me krijimin e një zone të tregtisë së lirë me Bashkimin, por në të përfshihen edhe disa angazhime politike të cilat edhe pse nuk kanë natyrë ligjore, përbëjnë bazat e ndryshimeve që do të pasojnë në kuadrin ligjor e institucional të vendit.

Një “konstrukt” i tillë i Marrëveshjes së Përkohshme, por edhe vetë natyra e marrëdhënieve dhe detyrimeve që ajo rregullon, e bëjnë atë disi të komplikuar dhe të vështirë për tu absorbuar nga një audiencë e pa-specializuar në fushën e marrëdhënieve ekonomike e posaçërisht në procesin e integritit evropian. Përvoja e vendeve të tjera të rajonit - si Maqedonia e Kroacia - tregon se MSA dhe MP paraqiten të ndërlikuara edhe për administratën shtetërore, përvojë e cila sigurisht që konfirmohet edhe në rastin e vendit tonë. Studimi më i fundit mbi nivelin e njohurive të administratës qendrore e lokale, institucioneve të pavarura dhe gjyqësorit në lidhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ka identifikuar një sërë keqkuptimesh dhe mangësi në njohjen e kësaj Marrëveshjeje.<sup>3</sup>

Ky botim i Ministrisë së Integritit Europian vjen në kuadër të aktiviteteve informuese të saj, duke synuar të sjellë Marrëveshjen e Përkohshme në tërësinë e vet më pranë publikut dhe veçanërisht segmenteve kyçe të sektorit publik - administratës publike, institucioneve të pavarura etj. Botimi është konceptuar në formën e një manuali i cili u prezanton lexuesve të drejtat dhe detyrimet e Shqipërisë që burojnë nga MP si edhe i udhëzon ata se si të “lexojnë” më tej pjesët shoqëruese të kësaj marrëveshje - shtojcat dhe protokollet. Për këtë, manuali ndjek thujtë të njëjtën strukturë si në tekstin e Marrëveshjes së Përkohshme, i pasuruar më tej me shpjegime dhe referenca shtesë.

 <sup>2</sup> Bëhet fjalë për dispozita të përgjithshme dhe dispozita në lidhje me funksionimin e Komitetit të Përbashkët (Joint Committee) organ i cili deri në hyrjen në fuqi të MSA do të ushtrojë kompetencat që MSA i nje Këshillit të Stabilizim Asocimit dhe Komitetit të Stabilizim Asocimit. Sipas nenit 56 të MP, me hyrjen në fuqi të saj “nenet 3 deri 14 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Shqipërisë nënshkruar më 11 maj 1992, do të pushojnë efektet”.

<sup>3</sup> Shih “Shqipëria dhe Bashkimi Evropian - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe më pas”, Ministria e Integritit 2007.

## II.

# Struktura dhe Natyra e Marrëveshjes së Përkohshme

Marrëveshja e Përkohshme përbëhen nga 56 nene - pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit e cila, ndryshe nga MP (tashmë, në fuqi), do të hyjë në fuqi pas ratifikimit prej 27 vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Dispozitat e MP në pjesën më të madhe përbëjnë detyrime të përcaktuara qartë ose më saktë - norma ligjore, ndërkohë që disa prej neneve të saj shprehin vullnetin e palëve për të arritur synime të caktuara (neni 30/1, neni 33/5 dhe 6, neni 41/1 apo neni 48 i MP). Vetë MP është ndarë në 4 Tituj nga të cilët Titulli II (Lëvizja e lirë e mallrave) përbëhet nga 3 Kapituj - Produkte industriale; Bujqësia dhe peshkimi; dhe Dispozita të përbashkëta (për Titullin II).

Pjesë përbërëse të MP (Neni 51) janë edhe Shtojcat dhe Protokollat e saj si më poshtë:


- **Shtojca I** - Koncesione Tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit;
- **Shtojca II (a)** - Tarifat koncesionare shqiptare për prodhimet primare bujqësore të prodhuara në komunitet [*referuar Neni 27/3(a) i MSA ose Neni 14/3(a) i MP*];
- **Shtojca II (b)** - Tarifat e koncesioneve Shqiptare për produktet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet [*referuar Neni 27/3(b) i MSA ose Neni 14/3(b) i MP*];
- **Shtojca II (c)** Tarifat koncesionare Shqiptare për produktet bazë bujqësore të prodhuara në komunitet [*referuar Neni 27/3(c) i MSA ose Neni 14/3(c) i MP*];
- **Shtojca III** Tarifat koncesionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar;
- **Shtojca IV** (*Neni 73 i MSA ose Neni 39 i MP*) - Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare;
- **Protokolli 1** mbi prodhimet e hekurit dhe çelikut;
- **Protokolli 2** mbi tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore të përpunuara;
- **Protokolli 3** mbi koncesionet preferenciale reciproke për disa lloje

vere, njohja reciproke dhe kontrolli i verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e verërave të aromatizuara;

- **Protokolli 4** përkufizimi i konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ;
- **Protokolli 5** (*ose ndryshe, Protokollin 6 i MSA*) mbi ndihmën e ndërsjelltë administrative në çështje doganore.<sup>4</sup>

Ashtu siç vërehet edhe nga vetë titulli i MP, palët kanë rënë dakord që Marrëveshja do të jetë e përkohshme - deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit - gjë që përcaktohet qartë që në preambulën e MP. Marrëveshja synon forcimin dhe thellimin e marrëdhënieve ekonomike të vendosura me Marrëveshjen e Bashkëpunimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Shqipërisë (1992)<sup>5</sup>. Pra MP përbën pasuesen e Marrëveshjes së 1992, e cila, nga ana tjetër, shfuqizohet pjesërisht (nenet 3 deri 14) ndërsa disa dispozita të veçanta do të vazhdojnë të zbatohen në kuadër të MP - deri në hyrjen në fuqi të MSA. Këto dispozita (të Marrëveshjes së 1992) kanë të bëjnë me parime të përgjithshme të marrëveshjes (neni 1 dhe 2) dhe të bashkëpunimit ekonomik (neni 15, 16 dhe 17), Komitetin e Përbashkët (neni 18), si edhe dispozita të përgjithshme e përfundimtare (neni 19 - 22).

Parë nga ky këndvështrim, pjesërisht mund të “justifikohet” edhe përkthimi i titullit të MP si Marrëveshje e Ndërmjetme, pasi ajo shërben si një “instrument ndërmjetësues” në kalimin nga marrëdhënia e mëparshme kontraktuale e krijuar me Marrëveshjen e 1992 (pjesërisht në fuqi) në marrëdhënien pasuese kontraktuale - Marrëveshje Stabilizim Asocimi. Dispozitat më të rëndësishme të cilat MP i “huazon” nga Marrëveshja e 1992 janë ato që kanë të bëjnë me Komitetin e Përbashkët. Më saktë, në bazë të nenit 42 të MP, Komiteti i përbashkët i ngritur sipas Marrëveshjes së vitit 1992 do të ushtrojë kompetencat dhe do të përmbushë detyrat që MP ia ngarkon Këshillit të Stabilizim-Asocimit ose Komitetit të Stabilizim-Asocimit. Gjithashtu, ky Komitet

 <sup>4</sup> Siç shihet nga më sipër, renditja e neneve apo protokolleve të MP ndryshon nga ajo e MSA - pjesë përbërëse të së cilës ato janë. Protokollin 5 i MP për shembull në MSA është Protokollin 6, apo, neni 39 i MP është neni 73 i MSA. Për arsye praktike, botimi i referohet neneve, shtojcave e protokolleve të MP sipas renditjes dhe emërimit në Marrëveshjen e Përkohshme. Në fakt, neni 51 i MP (MSA neni 129) përcakton se “Referimi i shtojcave dhe protokolleve për nenet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit duhet të lexohen si referuese të neneve të Marrëveshjes së Përkohshme siç tregohet në titujt e neneve të Marrëveshjes aktuale.”

<sup>5</sup> Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Shqipërisë në pjesën vijuese të tekstit do t'i referohemi si “Marrëveshja 1992”.

do të veprojnë në përputhje me të njëjtat modalitete që janë praktikuar deri tani në objektin e Marrëveshjes për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik (1992).

Marrëveshja e Përkohshme midis vendit tonë dhe Bashkimit Europian është vërtet një marrëveshje komplekse jo vetëm nga përmbajtja e dispozitave të saj në lidhje me tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik por edhe nga aspekti i marrëdhënieve që ajo vendos me instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë që burojnë prej tyre. Përveç MSA dhe Marrëveshjes së 1992 midis KE dhe Shqipërisë, Marrëveshja e Përkohshme i referohet gjithashtu edhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare tek të cilat Shqipëria ka aderuar (Marrëveshja për Bujqësinë -GATT 1994, Marrëveshja e OBT etj.) ose ka pranuar (nën MP) që të respektojë rregulla të caktuara (p.sh. Traktati themelues i Komunitetit Europian dhe instrumentet specifike të Komunitetit të miratuar mbi këtë bazë).

Më tej, ndonëse Marrëveshja e Përkohshme në perceptimin e publikut lidhet kryesisht vetëm me çështje që kanë të bëjnë me tregtinë midis dy vendeve - tarifave doganore për shkëmbimet tregtare - ky nuk mund të jetë objekti i vetëm i MP veçanërisht duke pasur parasysh synimin kryesor të saj - krijimi i një zone të tregtisë së lirë brenda një periudhe 10 vjeçare prej hyrjes në fuqi të MP. Kjo do të thotë se përveç tarifave doganore të mallrave, afateve kohore dhe kuotave të aplikimit të tyre, MP nuk mund të shmangë aspekte të rëndësishme të funksionimit të një tregu të lirë, të tilla si konkurrenca, ndihmat shtetërore etj. Për këtë arsye palët e marrëveshjes kanë rënë dakord për respektimin e disa parimeve bazë të funksionimit të një tregu të lirë, duke njohur kështu rëndësinë e respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut, parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, të zbatimit të ligjit, ekonomisë së tregut, bashkëpunimit rajonal etj. Në këtë kontekst Shqipëria ka ndërmarrë një sërë angazhimesh të cilat duhet t'i përmbushë brenda afteve kohore të përcaktuara qartë në Marrëveshjen e Ndërmjetme, veçanërisht përsa i përket konkurrencës së lirë (*Shih Titullin III të MP*).

Në mënyrë që të sigurohet monitorimi i përmbushjes së detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Përkohshme, respektimi i dispozitave të saj prej palëve nënshkruese dhe eventualisht, zgjidhja e mosmarrëveshjeve apo paqartësive midis palëve nënshkruese në lidhje me zbatimin e saj, MP në Titullin IV parashikon edhe modalitetet e nevojshme në këtë kontekst. Pjesa vijuese ofron një përshkrim të shkurtër të modaliteteve dhe strukturave që sigurojnë zbatimin e marrëveshjes.

III.

# Institucionet dhe modalitetet e Marrëveshjes së Përkohshme

Ashtu siç u përmend edhe më sipër Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon ngritjen e dy strukturave bazë - Këshilli i Stabilizim Asociimit dhe Komiteti i Stabilizim Asociimit - të cilat do të fillojnë të funksionojnë vetëm pasi MSA të ketë hyrë në fuqi. Deri në atë moment do të jetë Komiteti i Përbashkët i ngritur nën Marrëveshjen e 1992 i cili do të ushtrojë kompetencat e Këshillit të SA dhe Komitetit të SA.

## BOX nr. 1

### ***NENI 117 (MSA)***

- 1. Këshilli i Stabilizim Asociimit përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarë të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, nga njëra anë, dhe anëtarë të Qeverisë së Shqipërisë, nga ana tjetër.*
- 2. Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos rregulloren e brendshme të tij.*
- 3. Anëtarët e Këshillit të Stabilizim Asociimit mund të përfaqësohen, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren e brendshme.*
- 4. Këshilli i Stabilizim Asociimit kryesohet me rotacion nga një përfaqësues i Komunitetit Evropian dhe një përfaqësues i Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.*
- 5. Banka Evropiane e Investimeve merr pjesë, si vëzhguese gjatë punimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, për çështjet që lidhen me të.*

### ***NENI 120 (MSA)***

- 1. Këshilli i Stabilizim Asociimit asistohet gjatë zbatimit të detyrave të tij nga Komiteti i Stabilizim Asociimit, i përbërë nga përfaqësues*

të Këshillit të Bashkimit Evropian e përfaqësues të Komisionit të Komunitetit Evropian, nga njëra anë, dhe përfaqësues të Shqipërisë, nga ana tjetër.

2. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos detyrat e Komitetit të Stabilizim Asociimit, të cilat përfshijnë përgatitjen e takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, dhe vendos për mënyrën e funksionimit të Komitetit

3. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund t'i delegojë Komitetit të Stabilizim Asociimit cilëndo kompetencë të tij. Në këtë rast Komiteti i Stabilizim Asociimit merr vendimet e tij duke ju përmbajtur kushteve të parashikuara në nenin 117.

4. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të vendosë të ngrejë komitete ose organe të tjera të veçanta, që mund ta ndihmojë atë në kryerjen e detyrave të tij. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asociimit vendos përbërjen dhe detyrat e komiteteve apo organeve të tilla dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

*Shënim: Këto nene nuk janë pjesë e Marrëveshjes së Përkohshme*

## **BOX nr. 2**

### **NENI 18 I MARRËVESHJES 1992 - KOMITETI I PËRBASHKËT**

#### **Neni 18**

1. (a) Do të ngrihet një Komitet i Përbashkët me përfaqësues të Komunitetit nga njëra anë dhe përfaqësues të Shqipërisë nga ana tjetër.

(b) Komiteti i Përbashkët do të formulojë rekomandime nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Palëve Kontraktuese.

(c) Sipas nevojës, Komiteti i Përbashkët do të miratojë vetë rregullat proceduriale dhe programin e punës.

(d) Komiteti i Përbashkët do të zhvillojë takime një herë në vit në Bruksel dhe Tiranë. Takimet e veçanta mund të organizohen nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët, pas kërkesës së njëres prej Palëve Kontraktuese. Komiteti i Përbashkët do të drejtohet me rradhë prej secilës nga Palët Kontraktuese. Kurdoherë që të jetë e mundur axhenda për takimet e Komitetit të Përbashkët do të miratohet paraprakisht.

(e) Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të krijojë grupe pune për ta ndihmuar në kryerjen e detyrave.

2. (a) Komiteti i Përbashkët do të sigurojë funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje dhe do të hartojë dhe rekomandojë masa praktike për arritjen e objektivave, duke mbajtur parasysh politikat ekonomike dhe sociale të Palëve Kontraktuese.

(b) Komiteti i Përbashkët do të përpiqet të gjejë mënyra për të nxitur zhvillimin e tregëtisë dhe bashkëpunimit tregëtar dhe ekonomik ndërmjet Palëve Kontraktuese. Në veçanti, ai do të:

- analizojë aspektet e ndryshme të tregëtisë ndërmjet Palëve, veçanërisht formën e përgjithshme, nivelin e rritjes ekonomike, strukturën dhe ndryshueshmërinë, balancën tregëtare dhe forma të ndryshme të tregëtisë dhe nxitjes së tregëtisë,

- do të bëjë rekomandime për çdo problem tregëtar ose të bashkëpunimit ekonomik me interes të ndërsjelltë,

- do të kërkojë mjetet për të shmangur vështirësitë e mundshme në fushën e tregëtisë dhe bashkëpunimit dhe do të nxisë forma të ndryshme të bashkëpunimit tregëtar dhe ekonomik në fushat me interes të ndërsjelltë,

- do të marrë në konsideratë masa që mund të zhvillojnë shumëllojshmërinë e tregëtisë dhe bashkëpunimit ekonomik, në veçanti nëpërmjet përmirësimit të mundësive të importit në Komunitet dhe Shqipëri,

- do të shkëmbejë informacion për planet dhe parashikimet makroekonomike të ekonomive të të dyja Palëve, të cilat kanë impakt mbi tregëtinë dhe bashkëpunimin dhe, në vijim, mbi qëllimin për të zhvilluar plotësueshmëri ndërmjet ekonomive përkatëse dhe gjithashtu mbi programet e propozuara të zhvillimit ekonomik,

- do të shkëmbejë informacion për amendimet dhe zhvillimin e ligjeve, rregulloreve dhe formaliteteve të Palëve Kontraktuese në fushat që mbulohen prej kësaj Marrëveshjeje,

- do të kërkojë metoda për të rregulluar dhe nxitur shkëmbimin e informacionit dhe kontakteve për çështje që lidhen me bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Palëve Kontraktuese mbi bazë avantazhesh të ndërsjellta, dhe të punojë për krijimin e kushteve të favorshme për një bashkëpunim të tillë,

- do të analizojë situatën lidhur me procedurat për fitimin e kontratave për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve pas një ftese ndërkombëtare për të marrë pjesë në tender,

- do të shqyrtoj pozitivisht mënyra për të përmirësuar kushtet e zhvillimit të kontakteve të drejtëpërdrejta ndërmjet firmave të

*vendosuara në Komunitet dhe atyre të vendosura në Shqipëri, - do të formulojë dhe dorëzojë pranë autoriteteve të të dyja Palëve Kontraktuese rekomandime për të zgjidhur çdo problem që mund të lindë, kur nevojitet nëpërmjet mjeteve të konkludimit të ujdive ose marrëveshjeve.*

Komiteti i përbashkët ka të drejtë jo vetëm të bëjë rekomandime por edhe të marrë vendime në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e MP në rastet e specifikuar në të si edhe në rastet kur palët nënshkruese janë në konflikt për aspekte të ndryshme të aplikimit apo interpretimit të MP.<sup>6</sup> Për një sërë çështjesh MP parashikon në mënyrë taksative kompetencat e Komitetit të Përbashkët (si organ zëvendësues i Këshillit dhe Komitetit të SA) si ndërmjetësues në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo si strukturë ku palët bien dakord për hapat e mëtejshëm në zbatimin e MP.<sup>7</sup> Megjithatë, Komiteti i Përbashkët apo (me hyrjen në fuqi të MSA) Këshilli i SA dhe Komiteti i SA nuk duhen keqkuptuar si organe që zgjidhin konflikte të veçanta midis operatorëve ekonomikë (prodhues, ndërmarrje tregtare etj) dhe strukturave shtetërore të palëve nënshkruese. Përkundrazi, këto struktura dhe organet që ato do të krijojnë në bazë të Nenit 121 të MSA<sup>8</sup> kanë si subjekt vetëm palët nënshkruese (Shqipërinë dhe KE) dhe si objekt - vetëm çështjet që rregullon MP (e më vonë MSA). Pavarësisht se vendimet e këtyre organeve mund të jenë detyruese për palët, këto të fundit janë pjesë aktive e arritjes së konsensusit. Nga ana tjetër, personave fizikë dhe juridikë MP u siguron trajtim të barabartë para organeve administrative e gjyqësore të palëve për të mbojtur të drejtat e tyre në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Përkohshme (neni 45 i MP), ndërkohë që palët garantojnë zbatimin e saj pa diskriminim midis palëve - Shqipërisë e vendeve anëtare të KE - dhe qytetarëve apo kompanive të tyre (neni 47 i MP).

Marrëveshja e Përkohshme është detyruese për palët në tërësinë e vet dhe ajo i përcakton qartë të gjitha përjashtimet apo rrethanat në të cilat dispozita të veçanta të saj mund të mos zbatohen prej palëve - p.sh. Nenet 18, 25, 26, 35 apo 37 të MP. Marrëveshja parashikon tre raste specifike për të cilët u njeh palëve të drejtën të marrin masa të veçanta dh kjo pa asnjë lloj pengese nga dispozitat e MP. Më saktë, në Nenin 46 të MP palët kanë rënë dakord sa më poshtë:



<sup>6</sup> Shih nenet 42 - 44 të Marrëveshjes së Përkohshme.

<sup>7</sup> Dispozita të tilla përmbajnë nenet 25 (Masat mbrojtëse), 26 (Klauzola e pamjaftueshmërisë), neni 30 etj.

<sup>8</sup> "Komiteti i Stabilizim Asociimit mund të krijojë nën-komitete". (Neni 121 i MSA - nuk është pjesë e Marrëveshjes së Përkohshme.)

“Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë të marrë masa:

- a) të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat thelbësorë të sigurisë;
- b) të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve ose materialeve luftarake, ose me kërkimin shkencor, zhvillimin ose prodhimin e domosdoshëm për çështjet e mbrojtjes, me kusht që këto masa të mos dëmtojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me produktet që nuk destinohen për qëllime specifike ushtarake;
- c) të cilat ajo i konsideron thelbësore për sigurinë e saj, në rastin e trazirave serioze të brendshme që çenojnë ruajtjen e rendit dhe të ligjeve, në kohë lufte ose tensioni ndërkombëtar serioz që përbën një kërcënim lufte, ose me qëllim që të përmbushë detyrimet që ka pranuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”.

Më tej, Marrëveshja e Përkohshme u njeh palëve të drejtën për të reaguar duke marrë masat e duhura në rast se mendon se pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të MP (Neni 49 i MP). Sidoqoftë, në të tilla raste MP kërkon që palët t'i drejtohen Këshillit të Stabilizim Asocimit për gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme nëpërmjet konsultimeve.<sup>9</sup>

Strukturat institucionale të Marrëveshjes së Përkohshme - Komiteti i Përbashkët, Këshilli i SA dhe Komiteti i SA - si dhe modalitetet e zbatimit të saj nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme mes palëve ofrojnë në këtë mënyrë një proces konstruktiv dhe efektiv për krijimin e një zone të tregtisë së lirë brenda një afati kohor prej 10 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të MP. Kjo marrëveshje njeh plotësisht pozitat aktuale të ekonomisë shqiptare dhe për këtë ajo parashikon hapje graduale të tregut vendas ndaj konkurrencës europiane ndërkohë që tregu i KE është hapur plotësisht për produktete shqiptare. Nga ana tjetër, afatet e përcaktuara për hapjen e tregut shqiptare si edhe detyrimet e ndërmarra paralajmërojnë një sërë sfidash për tregun dhe ekonominë shqiptare, adresimi i të cilave - ndonëse kompleks - do të sjellë përfitimet e veta. Lëvizja e lirë e mallrave përbën një nga parimet bazë dhe njëkohësisht, pikënisjen kryesore të Marrëveshjes së Përkohshme në funksion të krijimit të një zone të tregtisë së lirë me KE. Regjimi i ri i marrëdhënieve tregtare midis Shqipërisë dhe Komunitetit Europian përcaktohet nën Titullin II të MP si edhe në Shtojcat dhe Protokollin e Marrëveshjes të cilat trajtohen më poshtë në këtë tekst.

<sup>9</sup> Palët gjithashtu mund të tërhiqen plotësisht nga MP e cila shfuqizohet 6 muaj pas datës së njoftimit të palës.

## IV. Lëvizja e lirë e mallrave

Krijimi i një zone të tregtisë së lirë në parim nënkupton heqjen e barrierave dhe kufizimeve në marrëdhëniet tregtare midis palëve si tarifa doganore, kufizimet sasiore apo masa të tjera me efekt të njëjtë me to. Ndërkohë që në rastin e ekonomive me nivel të përafërt ose të njëjtë zhvillimi krijimi i zonave të tilla mund të kalojë nëpërmjet modaliteteve më të thjeshta dhe pa shumë vonesa, në rastet kur zhvillimi dhe niveli ekonomik i palëve nuk është i njëjtë, hapja e menjëhershme e tregut të pazhvilluar ndaj një tregu tjetër dukshëm më të avancuar e konkurrues do të kishte pasojë negative për të parin. Ky moment është marrë parasysh dhe është në themel të eksperiencës së Bashkimit Europian me vendet e tjera të stabilizim asociimit të cilat kanë nënshkruar një Marrëveshje stabilizim asociimi, fazë e cila shpesh është paraprirë nga një periudhë relativisht e gjatë e karakterizuar nga marrëdhënie tregtare të hapura të njëanshme (nga Bashkimi Europian). Kështu, prej vitit 2000 Komisioni Europian u akordoi vendeve të Ballkanit Perëndimor një regjimin tregtar preferencial i cili konsistonte në faktin se Bashkimi Europian bëri 0% të gjitha tarifatat doganore për produktet industriale dhe bujqësore me përjashtim të tre produkteve: mishi i qingjit të njomë, veza dhe disa produkte të peshkut.<sup>10</sup>

Parë nga ky këndvështrim, Marrëveshja e Përkohshme para së gjithash sjell ndryshime në regjimin tregtar të Shqipërisë me BE në sensin që rregullon hapjen e tregut shqiptar në mënyrë graduale ndaj atij të Komunitetit Europian (vendet në territorin e të cilave zbatohet Traktati i Komunitetit Europian). Marrëveshja e Përkohshme e posaçërisht Titulli II i saj (Lëvizja e lirë e mallrave) është hartuar në respekt të plotë të parimeve e dispozitave të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), e sidomos nenit XXIV të GATT (1994).<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Rregullorja Nr. 2000/2007 e Komisionit Europian.

<sup>11</sup> Neni 2 dhe 3/1 i Marrëveshjes së Përkohshme.

## BOX Nr. 3

### *Neni XXIV i GATT (1994)*

#### *Neni XXIV*

*Zbatimi Territorial - Trafiku Kufitar - Bashkimet Doganore dhe Zonat e Tregtisë së Lirë*

*1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në territorin doganor metropolitan të palëve kontraktuese gjithashtu dhe në të gjitha territoret e tjera doganore në lidhje me të cilët është pranuar kjo Marrëveshje sipas kushteve të nenit XXVI ose që është duke u zbatuar në bazë të nenit XXXIII apo konform Protokollit të Zbatimit Provizor. Secili prej këtyre territoreve doganore do të konsiderohet si të jetë palë kontraktuese, ekskluzivisht për qëllimet e zbatimit territorial të kësaj Marrëveshjeje; Me kusht që dispozitat e këtij paragrafi nuk do të interpretohen së krijojnë të drejta dhe detyrime ndërmjet dy apo më shumë territoreve doganore në lidhje me të cilët kjo Marrëveshje është pranuar sipas kushteve të nenit XXVI ose është duke u zbatuar në bazë të nenit XXXIII apo konform Protokollit të Zbatimit Provizor nga një palë e vetme kontraktuese.*

*2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me territor doganor do të kuptohet territori për të cilin mbahen tarifa doganore të ndara apo rregullime të tjera tregtare të ndara për një pjesë domethënëse të tregtisë së saj me territoret e tjera.*

*3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen për të penguar:*

*a) nga një palë kontraktuese për vendet kufitare për të lehtësuar trafikun ndërkufitar;*

*b) përfitimet e dhëna në tregtinë me Territoret e Lira të Triestes nga vendet kufitare të këtij territori, me kusht që këto përfitime nuk janë në kundërshtim me dispozitat e Traktateve të Paqes që vijuan nga Lufta e Dytë Botërore.*

*4. Palët kontraktuese njohin që është e dëshirueshme rritja e lirisë së tregtisë, duke zhvilluar nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare, një integrim më të ngushtë të ekonomive të vëndeve, që janë palë në marrëveshje të tilla. Ato njohin gjithashtu që vëndosja e një bashkimi doganor apo e një zone të lirë tregtare duhet të ketë për objekt lehtësimin e tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse dhe jo të vëndosë pengesa në tregtinë e palëve të tjera kontraktuese me këto vënde.*

5. Si rrjedhim, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të përbëjnë pengesë, ndërmjet territoreve të palëve kontraktuese, për vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të lirë tregtare ose për miratimin e një marrëveshjeje provizore të nevojshme për vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të lirë tregtare. Me kusht:

a) që, në rastet e një bashkimi doganor ose të një marrëveshjeje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një bashkimi doganor, tarifrat doganore si dhe rregulloret e tjera të tregtisë të zbatuara si pasojë e vëndosjes së këtij bashkimi ose të lidhjes të kësaj marrëveshjeje provizore nuk do të jenë, në tërësinë e tyre, për sa i përket tregtisë me palët kontraktuese të cilat nuk janë palë në të tilla bashkime apo marrëveshje, më të larta ose më kufizuese së rritjet e përgjithshme të detyrimeve dhe rregullave të tregtisë që zbatoheshin në territoret përbërëse të këtij bashkimi përpara vëndosjes së bashkimit ose të lidhjes të marrëveshjes, sipas rastit;

b) që, në rastet e një zone të lirë tregtare ose të një marrëveshjeje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një zone të lirë tregtare, tarifrat doganore si dhe rregulloret e tjera të tregtisë të mbajtura në secilin territor përbërës dhe të zbatuara, si pasojë e vëndosjes së zonës së tregtisë së lirë ose e lidhjes të marrëveshjes provizore, në tregtinë e palëve kontraktuese të cilat nuk bëjnë pjesë në një zonë të tillë ose që nuk janë palë në një marrëveshje të tillë, nuk do të jenë më të larta ose më kufizuara sesa tarifrat dhe rregulloret e tjera të tregtisë që i korrespondojnë atyre ekzistuese në territoret përbërëse përpara vëndosjes së zonës së tregtisë së lirë ose lidhjes të marrëveshjes provizore, sipas rastit; dhe

c) çdo marrëveshje provizore që përmendet në nënparagrafet a) dhe b) do të përfshijë një plan dhe një program për vëndosjen, në një afat të arsyeshëm, të bashkimeve doganore dhe të zonave të lira tregtare.

6. Në rast se, në përmbushje të kushteve të shprehura në paragrafin 5 a), një palë kontraktuese propozon të ngrejë një tarifë doganore në kundërshtim me dispozitat e Nenit II, do të jetë e zbatueshme procedura e parashikuar në Nenin XXVIII. Në përcaktimin e kompensimeve, do të mbahet parasysh kompensimi që rezulton tashmë nga reduktimet e bëra në tarifrat korresponduese të territoreve të tjera përbërëse të bashkimit.

7. a) Çdo palë kontraktuese e cila vëndos të hyjë në një bashkim doganor ose të bëjë pjesë në një zonë të lirë tregtare apo të marrë pjesë në një marrëveshje provizore të lidhur me qëllim vëndosjen e një bashkimi të tillë ose të një zone të tillë, do të njoftoje pa vonesë PALËT KONTRAKTUESE dhe do të sigurojë të gjithë informacionin e disponueshëm për sa i përket bashkimit apo zonës së propozuar, që do t'i mundësojë atyre t'i adresojnë palëve kontraktuese raportet dhe rekomandimet, të cilat ato i gjykojnë të përshtatshme.

b) Në rast se, pasi të kenë studiuar planin dhe programin e përfshirë në një marrëveshje provizore sipas paragrafit 5, në konsultime me palët e kësaj marrëveshjeje dhe duke marrë parasysh informacionin e dhënë në përputhje me nën paragrafin a), PALËT KONTRAKTUESE arrijnë në konkluzionin që marrëveshja nuk ka të ngjarë që të çojë në vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë brenda afateve të parashikuara nga palët kontraktuese në marrëveshje ose që këto afate nuk janë të arsyeshme, PALËT KONTRAKTUESE do të adresojnë rekomandime për palët e marrëveshjes. Palët nuk do të mbajnë në fuqi apo nuk do zbatojnë marrëveshjen, sipas rastit, në rast se ato nuk janë të përgatitura për të modifikuar atë konform këtyre rekomandimeve.

c) Të gjitha modifikimet thelbësore të planit apo programit sipas nën paragrafit 5c) duhet t'u komunikohen PALËVE KONTRAKTUESE, të cilat mund t'u kërkojnë palëve kontraktuese në fjalë të hyjnë në konsultime me ato, në rast se modifikimet duken se do të kompromentojnë apo do të vonojnë pa të drejtë vëndosjen e bashkimit doganor ose të zonës së tregtisë së lirë.

8. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje,

a) me territor doganor do të kuptohet zëvëndësimi i një territori të vetëm doganor me një apo me shumë territore doganore, kur ky zëvëndësim ka për rrjedhojë:

i) që detyrimet doganore dhe rregullimet e tjera tregtare kufizuese (me përjashtim, kur kjo do të jetë e nevojshme, të kufizimeve të lejuara sipas neneve XI, XII, XIII, XIV, XV dhe XX) janë eliminuar për pjesën më të madhe të tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse të bashkimit, ose të paktën për pjesën më të madhe të tregtisë për produktet që e kanë origjinën nga këto territore; dhe

ii) Me kusht zbatimin e dispozitave të paragrafit 9, në pjesën më të madhe zbatohen të njëjtat detyrime doganore dhe rregullime

*të tjera tregtare nga secili prej vëndeve anëtare të bashkimit doganor për sa i përket tregtisë me territoret të cilat nuk janë përfshirë në bashkim;*

*b) Me zonë të tregtisë së lirë do të kuptohet një grup prej dy ose më shumë territoresh doganore brenda të cilave detyrimet doganore dhe rregullimet e tjera tregtare kufizuese (me përjashtim, kur kjo do të jetë e nevojshme, të kufizimeve të lejuara sipas neneve XI, XII, XIII, XIV, XV dhe XX) janë eliminuar për pjesën më të madhe të tregtisë ndërmjet territoreve përbërëse për sa i përket produkteve që e kanë origjinën në këto territore .*

*9. Preferencat e referuara në paragrafin 2 të nenit 1 nuk do të preken nga vëndosja e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë; megjithatë ato mund të eliminohen ose të rregullohen në rrugë negociimesh me palët kontraktuese të prekura. \* Kjo procedurë negociimi me palët kontraktuese të prekura do të zbatohet, veçanërisht, për eliminimin e preferencave që kërkohet të jenë në përputhje me dispozitat e nën paragrafeve a) i) dhe b) të paragrafit 8.*

*10. PALËT KONTRAKTUESE, me një vëndim të marrë me shumicën e dy të tretave, mund të aprovjnë propozimet të cilat nuk janë plotësisht konform dispozitave të paragrafëve 5 deri 9 me kusht që ato të çojnë në vëndosjen e një bashkimi doganor ose të një zone të tregtisë së lirë në kuptimin e këtij neni.*

*11. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të cilat rezultojnë nga themelimi i Indisë dhe Pakistanit si Shtete të pavarura dhe duke njohur që këto dy shtete kanë formuar për një kohë të gjatë një bashkësi ekonomike, palët kontraktuese bien dakort që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të mos i ndalojnë këtyre shteteve që të lidhin marrëveshje të veçanta që kanë të bëjnë me tregtinë ndërmjet tyre, në pritje që lidhjet e tyre reciproke tregtare të jenë vëndosur definitivisht. \**

*12. Secila palë kontraktuese do të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda kompetencave të saj në mënyrë që të sigurojë zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga qeveritë dha autoritetet rajonale dhe lokale brenda territorit të saj.*

Duke pasur parasysh parimin e marrëdhënies asimetrike të regjimit tregtar të palëve si edhe sensitivitetin e tyre ndaj hapjes së tregut për produkte të veçanta, MP ka sanksionuar një sistem të qartë të

regjimit tregtar për produkte të veçanta dhe në periudha kohore të caktuara. Kështu, për produktet që janë objekt i MP - produkte industriale, bujqësore, peshku dhe produktet e e tij, verërat dhe pijet alkolike - janë përcaktuar kushtet e shkëmbimeve tregtare në varësi të "ndjeshmërisë" së tyre për ekonominë shqiptare. Për produktet që nuk konsiderohen si sensitive tarifatat doganore të importit bëhen menjëherë 0% (e tarifës bazë që zbatohet *erga omnes* ditën para nënshkrimit të MP), kurse për ato produkte që janë shumë sensitive tarifatat doganore nuk ndryshojnë. Për produktet mesatarisht të ndjeshme palët kanë rënë dakord të reduktojnë në mënyrë graduale tarifatat doganore deri në zhdukjen e plotë të tyre dhe kjo brenda një periudhe prej 5 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme. Kuotat tarifore - kufizime sasiore - përbëjnë edhe një tjetër instrument mbrojtës për produkte të veçanta sensitive (p.sh. grurë i zakonshëm). Këto masa mbrojtëse për produktet e ndjeshme vendase synojnë konsolidimin e ekonomisë në ato segmente të saj dhe kjo si për produktet mesatarisht sensitive (për një periudhë 5 vjeçare) ashtu edhe për produktet shumë sensitive - për të cilat palët mund të vendosin më vonë që të rishikohen.

Titulli II i Marrëveshjes së Përkohshme (Neni 3 - 32) së bashku me Shtojcat I, II(a) II(b), II(c), III dhe Protokollet 1 - 4 të kësaj Marrëveshje përcaktojnë regjimin tregtar (eksport - import) të produkteve që janë objekt i MP - produkte industriale, bujqësore, peshku dhe produktet e e tij, verërat dhe pijet alkolike - si edhe rregulla që lehtësojnë zbatimin e tyre (Neni 19 - 32 i MP) si klauzolat e pezullimit, subvencioneve, pamjaftueshmërisë, monopole të shtetërore etj. Neni 3 i MP përcakton si tarifë bazë mbi të cilën zbatohen reduktimet e parashikuara tarifën e aplikuar *erga omnes* ditën para nënshkrimit të Marrëveshjes dhe tarifatat e reduktuara rrumbullakosën në numra të plotë. Pra, çdo reduktim (në %) i tarifës së importit për një produkt të caktuar bëhet mbi tarifën bazë, si më poshtë (*shih nenin 6 të MP*):

**Tabela 1.**

**Reduktimi i tarifës së importit të produkteve industriale  
(2006 - 2011)**

Produkti industrial X (Shtojca I)	MP hyn në fuqi (2006)	1 Janar 2007	1 Janar 2008	1 Janar 2009	1 Janar 2010	1 Janar 2011
Mënyra e reduktimit	Bëhet 80% e tarifës bazë	Bëhet 60% e tarifës bazë	Bëhet 40% e tarifës bazë	Bëhet 20% e tarifës bazë	Bëhet 10% e tarifës bazë	Tarifat e mbetura bëhen 0
Tarifa bazë e importit 10%	8%	6%	4%	2%	1%	0

Kushti kryesor që përcakton tarifën bazë për reduktimet sipas MP është zbatueshmëria e tij *erga omnes* dhe si rrjedhojë, çdo ulje e tarifës bazë e cila mund të zbatohet në të ardhmen *erga omnes* do të zëvendësojë tarifën bazë të MP (në bazë të së cilës bëhen reduktimet) nga dita kur tarifata e reja *erga omnes* fillojnë të aplikohen. Duke iu kthyer shembullit të mësipërm kjo do të thotë se, nëse p.sh. gjatë vitit 2008 tarifa e importit për produktin industrial "X" që zbatohet *erga omnes* 1 ditë para hyrjes në fuqi të MP (pra - tarifa bazë) zvogëlohet nga 10% në 5% atëherë prej ditës kur fillon aplikimi i tarifës së re (*erga omnes*), në bazë të MP për tregtinë midis palëve në vitin 2008 kjo tarifë do të jetë sa 40% e tarifës së re (5%).

## IV.1. Produktet industriale

Lista e produkteve industriale objekt i MP përfshin Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994). Kapitulli I i Titullit të II të MP si edhe Shtojca I dhe Protokollit I i marrëveshjes përcaktojnë rregullat specifike që aplikohen për këto produkte.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme të gjithë produktet industriale me origjinë nga Shqipëria mund të eksportohen në Komunitetin Europian pa tarifa doganore (tarifë doganore 0%) dhe pa kufizime sasiore (kuota) apo masa të tjera me efekt të njëjtë. Përsa i përket importit të produkteve industriale (në Shqipëri) me origjinë nga Komuniteti do të aplikohet i njëjti regjim si për eksportin e produkteve Shqiptare në Komunitet (tarifë doganore 0%) përveç produkteve të Shtojcës I (Koncesione Tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit) të MP për të cilat parashikohet ulje graduale si më sipër - *Shih Tabelën 1.*<sup>12</sup> Nëse i referohemi ndarjes së mësipërme të produkteve sipas ndjeshmërisë, produktet e Shtojcës I të MP konsiderohen si produkte të ndjeshme industriale - produktet e industrisë së kripës; së plehrave fosfate; së hidrokarbureve; sapun detergjentë; prodhimet e çelikut ; së riveshjes së gomave; prodhimet të lëkurëve; produktet çimento portland; artikuj prej allçie apo prej përbërjeve me bazë allçie; pllaka dyshemeje etj. (*për listën e plotë të produkteve dhe kalendarin e reduktimit të tarifave shih Shtojcën I të MP*). Shqipëria, si subjekt i së drejtës preferenciale në këtë rast, mund të zvogëlojë detyrimet doganore të importit në tregtinë me komunitetin me ritme më të shpejta se ato të parashikuara në kalendarin e reduktimeve (Neni 6 i MP).


Duke pasur parasysh rëndësinë e produkteve të hekurit dhe çelikut (Kapitulli 72 dhe 73 i Nomenklaturës së Kombinuar) për zhvillimin ekonomik të vendit dhe gjithashtu edhe nivelin aktual të zhvillimit të kësaj industrie në Shqipëri, pozita e këtyre produkteve në regjimin e ri tregtar me KE trajtohet në një protokoll të veçantë - Protokollit I mbi prodhimet e hekurit dhe çelikut. Përveç dispozitave që kanë të

<sup>12</sup> Neni 6 i MP. Gjithashtu në pikën 3 të këtij neni ndalohej aplikimi i masave sasiore kufizuese për importin e këtyre produkteve në Shqipëri. Në të njëjtën linjë është edhe neni 8 i MP me të cilin palët kanë rënë dakord të mos aplikojnë tarifa doganore apo kufizime sasiore mbi eksportet e tyre.

bëjnë me aplikimin e tarifave doganore dhe masave kufizuese (*shih më sipër*), Protokollin I lejon marrjen e masave të caktuara që ndihmojnë zhvillimin e këtij sektori (ndihma shtetërore) gjatë pesë viteve të para pas hyrjes në fuqi të MP. Pas kësaj periudhe do të jenë rregullat e Komunitetit ato që do të rregullojnë ndihmën shtetërore çka do të thotë se ndihma shtetërore që Shqipëria do të japë për industri të veçanta duhet të jetë në përputhje me rregullat e Traktatit të Komunitetit Europian dhe dispozitat e tjera komunitare të miratuara mbi këtë bazë. Gjithashtu, Shqipëria do të hartojë edhe një program ristrukturimi për këtë industri brenda tre viteve duke përfituar nga asistenca e KE. Palët do të jenë transparente përsa i përket zbatimit të këtyre masave të cilat do të monitorohen nga Këshilli i Stabilizim Asocimit.

## IV.2. Produktet bujqësore

Kapitulli II i Titullit të II të Marrëveshjes së Përkohshme përcakton rregullat që do të zbatohen në tregtinë midis Shqipërisë dhe Komunitetit për produktet bujqësore, peshkun dhe produktet e peshkut: Kapitujt 1 - 24 të Nomenklaturës së kombinuar dhe produktet e renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994). Në lidhje me produktet bujqësore, posaçërisht, produktet bujqësore primare, rregulla më specifike përcaktohen në Shtojcat II(a), II(b) dhe Shtojcën II(c) të MP. Gjithashtu pjesë përbërëse të këtij seti rregullash janë edhe Protokollin 2 (Mbi tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore të përpunuara) dhe Protokollin 3 (Mbi konçensionet preferenciale reciproke për disa lloje vere, njohja reciproke dhe kontrollin e verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e verërave të aromatizuara) i Marrëveshjes së Përkohshme.<sup>13</sup> Produktet bujqësore së bashku me ato të peshkut (që do të trajtohen më poshtë) zënë në fakt pjesën më të madhe të rregullave specifike për tregtinë e produkteve mes palëve. Rregullat e liberalizimit të tregut për këto produkte janë më të detajuara, jo vetëm për specifikën e këtij sektori por edhe për shkak të rëndësisë së tij për palët.<sup>14</sup>

 <sup>13</sup> Në mënyrë që Shqipëria të përfitojë nga regjimi preferencial i importeve në Komunitet (tarifa doganore 0%) produktet bujqësore duhet të plotësojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara nga Komuniteti (siguria ushqimore, standarte të cilësisë, etj).

<sup>14</sup> Në parim palët kanë rënë dakord që të heqin të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë për këto produkte (Neni 13 i MP), përveç rasteve të përcaktuara në mënyrë taksative në MP (p.sh. neni 14 / 2).

Produktet bujqësore ndahen në dy kategori:

- **Produkte bujqësore primare** - prodhimet bujqësore që dalin direkt nga toka e pema, të cilat përdoren për konsum, si lëndë e parë apo i nënshtrohen përpunimeve të mëtejshme (frutat, perimet, qumështi, etj); dhe
- **Produkte bujqësore të përpunuara** - prodhime që i janë nënshtuar procesve përpunuese dhe kanë vlerë të shtuar (likotë e frutave, turshitë e perimeve, bulmetet, etj.).

Bazuar në kriterin e ndjeshmërisë së produkteve Shqipëria dhe Komuniteti kanë përcaktuar rregulla të ndryshme të shkëmbimeve tregtare për produktet bujqësore të cilat mund të kategorizohen si më poshtë:<sup>15</sup>

- Produkte jo sensitive - tarifat doganore të importit bëhen menjëherë 0%;
- Produkte mesatarisht sensitive - tarifat doganore reduktohen gradualisht për një periudhë pesëvjeçare;
- Produkte shumë sensitive- tarifat doganore nuk ndyshojnë (janë lënë jashtë MP).

Në bazë të nenit 14 të MP të gjitha produktet primare bujqësore shqiptare do të eksportohen pa tarifë doganore në Komunitet. Përjashtim bëjnë vetëm produktet e mëposhtme, nën kushtet e përcaktuara nga neni 14 pika 1 dhe 2:

- Produkteve me kod doganor 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204** të Nomenklaturës së Kombinuar (mishi i qengjit të njomë e gjedhit);
- Produktet e Kapitullit 7 dhe 8** (perimet dhe frutat) të Nomenklaturës së Kombinuar për të cilat do të aplikohet një detyrim doganor i veçantë me vlerë fikse por brenda një kuote prej 1000 tonë në vit;
- Produktet me kod doganor 1701 dhe 1702** me origjinë shqiptare do të mund të eksportohen në Komunitet pa tarifë doganore brenda 1 kuote prej 1000 tonë në vit.

Përsa i përket koncesioneve që Shqipëria u jep produkteve bujqësore primare me origjinë nga Komuniteti pra importit të tyre në Shqipëri,

<sup>15</sup> Ndjeshmëria e produkteve nuk është kategori e MP por thjesht kriter në bazë të të cilit palët janë udhëhequr në përcaktimin e rregullave të tregtisë midis tyre për produkte të veçanta.

në bazë të nenit 14 pika 3 shkronja a), b) dhe c) palët kanë rënë dakord për tre “nivele” liberalizimi të tregtisë. Produktet që janë subjekt i këtyre niveleve të liberalizimit të importit janë të listuara në shtojca të veçanta të MP dhe kjo<sup>16</sup>:

- **Shtojca II(a)** - Produkte bujqësore primare josensitive. Importi i Produkteve me origjinë nga Komuniteti bëhet me tarifë doganore 0% për sasi të pakufizuara që nga data e hyrjes në fuqi e MP (*për listën e plotë të produkteve shih Shtojca II(a) e MP - TARIFAT KONCENSIONARE SHQIPTARE PËR PRODHIMET PRIMARE BUJQESORE TË PRODHUARA NE KOMUNITET*);
- **Shtojca II(b)** - Produkte primare bujqësore mesatarisht sensitive. Tarifa doganore për importet e produkteve me origjinë nga Komuniteti të kësaj Shtojce reduktohet gradualisht sipas skemës së përcaktuar në këtë Shtojcë (**shih BOX nr.4**). *Për listën e plotë të produkteve nën këtë regjim tregtar shih Shtojca II(b) e MP - TARIFAT E KONÇESIONEVE SHQIPTARE PER PRODUKTET KRYESORE BUJQESORE TE PRODHUARA NE KOMUNITET*;
- **Shtojca II(c)** - Produkte primare bujqësore - grurë i fortë dhe grurë i zakonshëm - të cilat janë çliruar nga tarifatat doganore për kuota prej 20.000 tonë në vit nga dita e hyrjes në fuqi e MP. Kuota prej 20.000 tonë vlen për të dyja produktet së bashku. Nëse tejkalohet kjo kuotë, tarifa doganore për sasi të tjera të importuara do të jetë 2% (parimi i shfrytëzimit të kuotës është “përfiton kush vjen i pari”). *Për kodet doganore të këtyre (2) produkteve shih Shtojca II(c) e MP - TARIFAT KONCENSIONARE SHQIPTARE PËR PRODUKTET BAZË BUJQESORE TË PRODHUARA NË KOMUNITET*.

## BOX nr. 4

### **Reduktimi i tarifave doganore për produktet e Shtojcës II(b) të MP**

*Tarifat doganore për produktet e listuara në këtë shtojcë do të zvogëlohen dhe eliminohen në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:*


<sup>16</sup> Kodet doganore të cilave u referohen shtojcat e MP (kolona e parë majtas) janë ato të përcaktuara me Ligjin për Tarifat Doganore Nr. 8981 datë 12 Dhjetor 2003 “Për Aproximin e Nivelit të Tarifave Doganore” të Republikës së Shqipërisë (Fletorja Zyrtare Nr. 82 dhe Nr. 82/1 e vitit 2002) e amenduar me Ligj Nr. 9159 datë 8 Dhjetor 2003 (Fletorja Zyrtare Nr. 105 e vitit 2003) dhe Ligji Nr. 9330 datë 6 Dhjetor 2004 (Fletorja Zyrtare Nr. 103 viti 2004).

- Në datën e hyrjes në fuqi të MP, tarifa doganore e importit duhet të ulet në 90% të taksës doganore bazë;
- Më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të MP tarifa doganore e importit duhet të ulet në 80% të tarifës doganore bazë;
- Më 1 Janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të MP tarifa doganore e importit duhet të ulet në 60% të tarifës doganore bazë;
- Më 1 Janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të MP tarifa doganore e importit duhet të ulet në 40% të tarifës doganore bazë;
- *Më 1 Janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të MP tarifa doganore e importit duhet të ulet në 0% të tarifës doganore bazë.*

Regjimi tregtar (eksportet dhe importet) midis Shqipërisë dhe Komunitetit për produktet e përpunuara bujqësore përcaktohet me Protokollin 2 të Marrëveshjes së Përkohshme - Protokollin 2 Mbi tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore të përpunuara. Ky protokoll përmban 5 shtojca nga të cilat Shtojca I ka të bëjë me eksportet shqiptare në Komunitet, kurse Shtojcat II(a), II(b), II(c) dhe II(d) përcaktojnë rregullat për importet e produkteve me origjinë nga Komuniteti.<sup>17</sup>

Sipas këtij protokollin Këshilli i SA vendos për “zgjerimin e listës së produkteve bujqësore të përpunuara në bazë të këtij Protokollin; ndryshimin e detyrimeve të përmendura në Shtojcat I dhe II(b), II(c), II(d) të Protokollit 2; dhe për rritjen ose heqjen e kuotave tarifore” (Neni 1 pika 2 e Protokollit 2). Këto ndryshime bëhen në respekt të kushteve të përcaktuara në nenin 2 të Protokollit 2.

Shtojca I e Protokollit 2 - “Detyrime doganore të zbatueshme për importet në Komunitet të produkteve bujqësore të përpunuara me origjinë në Republikën e Shqipërisë” - përcakton listën e plotë të produkteve bujqësore të përpunuara me origjinë në Shqipëri, importi i të cilave në Komunitet bëhet me 0% detyrime doganore (*për listën e plotë shih Shtojca I e Protokollit 2*). Katër shtojcat e tjera të Protokollit 2 përcaktojnë rregullat (tarifat, kuotat) nën të cilat zhvillohet importi në Shqipëri i produkteve me origjinë nga Komuniteti dhe kjo si më poshtë:

 <sup>17</sup> Shtojcat I, II(a), II(b), II(c) dhe II(d) të Protokollit 2 nuk duhen ngatërruar me Shtojcat I, II(a), II(b) dhe II(c) të Marrëveshjes së Përkohshme. Edhe pse të dy grupet e shtojcave janë pjesë integrale e MP, grupi i parë janë shtojca të protokollit 2 dhe kanë të bëjnë me produktet e përpunuara bujqësore kurse grupi i dytë janë shtojca të MP (pra jo të ndonjë protokollin të saj) dhe kanë të bëjnë me produktet primare bujqësore.

- o **Shtojca II(a) e Protokollit 2** - Për produktet e listuara në këtë shtojcë detyrimet e importit caktohen në zero për importet drejt Shqipërisë për mallrat me origjinë në Komunitet *(për listën e plotë të produkteve Shih Shtojcën II(a) "Detyrime të zbatuara mbi importet në Shqipëri të produkteve bujqësore të përpunuara që e kanë origjinën në Komunitet" të Protokollit 2)*;
- o **Shtojca II(b) e Protokollit 2** - Detyrimet doganore për produktet e renditura në këtë shtojcë hiqen datën e hyrjes në fuqi të MP *(për listën e plotë të produkteve Shih Shtojcën II(b) "Konçesioni për tarifatat shqiptare për produktet e përpunuara bujqësore me origjinë në Komunitet" të Protokollit 2)*.
- o **Shtojca II(c) e Protokollit 2** - Detyrimet doganore për mallrat e renditura në këtë shtojcë reduktohen ose hiqen në përputhje me periodat kohore të përcaktuara në këtë shtojcë. Kalendarit e reduktimit të tyre në fakt është i njëjtë me atë që zbatohet për produkte primare bujqësore mesatarisht sensitive - **shih Box 4 më sipër**. *(Për listën e plotë të produkteve nën këtë regjim liberalizimi shih Shtojcën II(c) "Konçesioni për tarifatat shqiptare për produktet e përpunuara bujqësore me origjinë në Komunitet" të Protokollit 2)*.
- o **Shtojca II(d) e Protokollit 2** - Për produktet bujqësore të përpunuara të renditura në këtë Shtojcë, do të vazhdojnë të zbatohen detyrimet doganore për Kombet Më të Favorizuara nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes *(për listën e plotë të produkteve shih Shtojcën II(d) të Protokollit 2)*.

## IV.3. Vera dhe pijet alkolike

Ashtu si edhe produktet bujqësore të përpunuara, regjimi i tregtisë midis Shqipërisë dhe Komunitetit për verërat dhe pijet alkolike trajtohet në një protokoll të veçantë - "Protokollit 3 mbi konçesionet preferenciale reciproke për disa lloje vere, njohja reciproke dhe kontrolli i verërave, pijeve alkolike dhe emrat e verërave të aromatizuara" i Marrëveshjes së Përkohshme. Protokollit 3 përbëhet nga (neni 1 i Protokollit 3):

- a) Një marrëveshje mbi konçesionet tregtare preferenciale reciproke për disa lloje vere (**Shtojca I e këtij Protokollit**); dhe

- b) Një marrëveshje mbi njohjen reciproke, mbrojtjen dhe kontrollin e verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e llojeve të verëreve të aromatizuara (*Shtojca II e këtij Protokollit*).

Këto Marrëveshje zbatohen për llojet e verërave që ndodhen nën kreun nr. 22.04, pijet alkoolike nën kreun nr.22.08 dhe llojet e verërave të aromatizuara nën kreun nr. 22 05 të Sistemit të Harmonizuar të Konventës Ndërkombëtare mbi Përshkrimin e Harmonizuar të Mallrave dhe Sistemi i Kodimit, nënshkruar në Bruksel më 14 qershor 1983. Në Nenin 2 të Protokollit 3 përcaktohen në mënyrë specifike produktet që janë objekt i këtyre 2 marrëveshjeve (Shtojca I dhe II e këtij Protokollit) dhe kjo. verëra që janë prodhuar nga rrushi i freskët; pije alkoolike (sipas përkufizimeve përkatëse të këtij neni); dhe verëra të aromatizuara, pije të aromatizuara me bazë vere dhe koktej të aromatizuar me bazë vere, të referuara më poshtë si “verëra të aromatizuara” (sipas përkufizimeve përkatëse të këtij neni).

Në bazë të *Shtojcës I “Marrëveshja ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi konçensionet tregtare preferenciale reciproke për disa lloje vere”* të këtij Protokollit Shqipëria mund të eksportojë në Komunitet pa tarifë doganore produktet e mëposhtëm. *Shih Tabelën 2.*

**Tabela 2.**

**Konçensionet e Komunitetit për verërat me origjinë nga Shqipëria**

Kodi i nomenklaturës së kombinuar (CN)	Përshkrimi (në përputhje me Nenin 2(1)(b) i Protokollit 3	Detyrimi i zbatueshëm	Sasitë (hl)	Dispozitat specifike
ex 2204 10	Verë spumante cilësore	Përrjashtim	5000	(1)
ex 2204 21	Verë nga rrushi i freskët			
ex 2204 29	Verë nga rrushi i freskët	Përrjashtim	2000	(1)

(1) Konsultime me kërkesë të Palëve Kontraktuese mund të bëhen për të përshtatur kuotat duke transferuar sasi nga kuota që zbatohet për pozicionin ex 2204 29 në kuotën që zbatohet për pozicionet ex 2204 10 dhe ex 2204 21.

Kushti i vetëm që Shqipëria duhet të përmbushë për këtë regjim preferencial është që për eksportet e këtyre sasive nga Shqipëria të mos paguhet asnjë subvencion për eksportin. Ky detyrim duhet përmbushur edhe nga Komuniteti në lidhje me koncesionet shqiptare për importin e verërave me origjinë nga Komuniteti. Koncesionet shqiptare jepen më poshtë. *Shih Tabelën 3.*

**Tabela 3.**

***Koncesionet e Shqipërisë për verërat me origjinë nga Komuniteti***

Kodi shqiptar për	Përshkrimi (në përputhje me	Detyrimi i	Sasitë (hl)
tarifat doganore	Nenin 2(1)(a) i Protokollit 3	zbatueshëm	
ex 2204 10	Verë spumante cilësore	Përgjashtim	10000
ex 2204 21	Verë nga rrush i freskët		

Importet e verës sipas koncesioneve të parashikuara në këtë Marrëveshje i nënshtrohen paraqitjes së një certificate dhe një dokumenti shoqërues në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) Nr 885/2001 e 24 prillit 2001 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr 1493/1999 në lidhje me tregtinë me vendet e treta për produktet e sektorit të verërave të lëshuar nga një organ zyrtar i njohur reciprokisht që tregohet në listat e hartuara bashkarisht, me qëllim që vera në fjalë të përputhet me Nenin 2(1) të Protokollit 3.

***Marrëveshja e Shtojcës II të Protokollit 3*** është mjaft e detajuar dhe ajo ka të bëjë me njohjen reciproke, mbrojtjen dhe kontrollin e emrave të verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara. Kjo Marrëveshje përbëhet nga tre tituj: Titulli I - Njohja reciproke e emrave të verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara; Titulli II - Imponimi dhe ndihma reciproke ndërmjet autoriteteve kompetente dhe menaxhimi i marrëveshjes; dhe dispozitat e përgjithshme të Titulli III. Pjesë përbërëse të kësaj marrëveshje (Shtojca II e Protokollit 3) janë edhe dy Aneksat e saj:

- Aneksi I - Lista e Emrave të Mbrojtur (në Komunitet dhe Shqipëri); dhe
- Aneksi II - Lista e shprehjeve tradicionale dhe termave cilësore për verën në komunitet.<sup>18</sup>

<sup>18</sup> Në bazë të nenit 12 të Shtojcës II të Protokollit 3, në fund të këtij protokollit jepet edhe lista e pikave të kontaktit për Shqipërinë (në Ministrinë e Bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit) dhe Komunitetin (në Komisionin Europian).

Ashtu si edhe për produktet e tjera që janë subjekt i regjimit të përcaktuar nga Marrëveshja e Përkohshme, edhe për verërat dhe pijet alkolike një rëndësi të veçantë kanë rregullat e origjinës të cilat përcaktohen në Protokollin 4 të MP. Për shembull, në mënyrë që eksporti në Komunitet i një lloji të caktuar vere të mund të bëhet nën tarifën dhe kuotat tarifore të përcaktuara në Protokollin 3 të MP ajo duhet të jetë prodhuar nga rrushi i prodhuar në Shqipëri.

## IV.4. Peshku dhe produktet e peshkut

Grupi i fundit i produkteve objekt i Marrëveshjes së Përkohshme përfshin peshkun dhe produktet e peshkut. Në kuadër të angazhimeve që ka ndërmarrë Shqipëria në Organizatën Botërore të Tregtisë prej vitit 2002 tarifën doganore për importet e këtyre produkteve janë në nivelin 0%. Si rrjedhojë "pozita" e produkteve me origjinë nga Komuniteti për tu futur në tregun shqiptar është mjaft e mirë dhe cënimin e kësaj pozite në të ardhmen e ndalon kategorikisht nën 15 pika 2 e MP: "*Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria nuk zbaton detyrime të importit ose tarifa me efekt të njëjtë me to për peshkun dhe produktet e peshkimit që e kanë origjinën në Komunitetin Europian*". Komuniteti gjithashtu heq të gjitha detyrimet doganore për peshkun dhe produktet e tij me origjinë nga Shqipëria përveç produkteve (shqiptare) të listuara në Shtojcën III "Tarifat konçensionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar" të Marrëveshjes së Përkohshme. Për këto produkte Shtojca III e MP parashikon rregulla të veçanta të importit në Komunitet të cilat konsistojnë në atë që për kuota të caktuara vjetore tarifën doganore të eksportit të produkteve shqiptare (peshk dhe produktet e tij) në Komunitet janë 0% ndërsa për sasi të mbi këto kuota (kufizime sasiore) do të zbatohen tarifa doganore (tarifa të Kombit më të favorizuar - MFN) të cilat komunitet angazhohet t'i zvogëlojë për një periudhë tre vjeçare. *Për tarifën e sakta, kuotat dhe rregullat e tjera që aplikohen për eksportet e produkteve shqiptare (të peshkut e nënprodukteve të tij) në Komunitet shih Shtojca III e MP.*

Marrëveshja e Përkohshme përcakton të drejtën e Këshillit të SA për të shqyrtuar mundësinë që palët t'i ofrojnë koncesione të tjera njëra

tjetrës në lidhje me liberalizimin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe peshkut (Neni 16 i MP). Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e produkteve bujqësore dhe peshkimit, neni 18 i MP përcakton se palët do të hyjnë në konsultime për gjetjen e një zgjidhje të përshtatshme në rastet kur koncesionet e dhëna në Protokollin 2 të MP, Nenin 14 të MP dhe referencat e tij [Shtojcat II(a), II(b) dhe II(c) të MP dhe Protokollin 3 të MP] dhe në Nenin 15 (dhe Shtojcën III të MP) shkaktojnë çrregullime serioze në treg ose në mekanizmat rregullatorë të brendshëm. Kushte dhe rregulla të tjera specifike për raste të tilla apo të ngjashme për të gjitha produktet e Marrëveshjes së përkohshme sanksionohen në Nenet 25 dhe 30 të tij.

## IV.5. Dispozita të përbashkëta për lëvizjen e lirë të malrave

Dispozita të tjera që lidhen me aplikimin e rregullave të MP për lëvizjen e lirë të mallrave përcaktohen në kapitullin e fundit (III) të Titullit II të Marrëveshjes së Përkohshme. Nenet 19 - 32 të MP përmbajnë klauzola të veçanta të cilat do të aplikohen për të gjitha produktet që janë objekt i MP si pezullimi, dumpingu e subvencioni, masat mbrojtëse, klauzola e pamjaftueshmërisë etj.<sup>19</sup>

**Pezullimi** (Neni 20 i MP) - Në bazë të kësaj klauzole palët bien dakord që të mos vendosin tarifa të reja doganore apo masa me efekt të njëjtë për eksportet e importet dhe as të rrisin tarifatat ekzistuese prej datës së hyrjes në fuqi të MP. Gjithashtu, palët zotohen të mos aplikojnë kufizime sasiore të reja e masa të tjera me efekt të njëjtë apo të kufizojnë më tej kuotat ekzistuese. Pa çënuar lëshimet e bëra në bazë të nenit 13 (heqja reciproke e kufizimeve sasiore për produktet bujqësore dhe peshkimit), dispozitat e sipërpërmendura nuk kufizojnë ushtrimin e politikave bujqësore përkatëse të Shqipërisë dhe Komunitetit, ose marrjen e masave në kuadër të atyre politikave për sa kohë që këto veprime nuk ndikojnë në regjimin e importeve në Shtojcat II dhe III.

<sup>19</sup> Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe këtu ose në Protokollet 1, 2 dhe 3.

***Ndalimi i diskriminimit fiskal*** (Neni 21 e 22 i MP) - Krijimi i një zone të tregtisë së lirë nënkupton jo vetëm heqjen e tarifave doganor por gjithashtu edhe shmangien e masave ose praktikave me natyrë fiskale të brendshme të cilat shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim midis produkteve të njërës Palë dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e Palës tjetër. Shfuqizimi i tarifave doganore për importet aplikohet edhe tarifave doganore me natyrë fiskale.

***Dumpingu dhe Subvencioni*** (Neni 24 i MP) - Palët janë të lira të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në rast se zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumping dhe/ose subvencionim kundërveprues. Sidoqoftë këto masa duhet të jenë në përputhje me nenin 25 të MP (Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse), me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifave dhe Tregtinë 1994, me Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese si edhe me legjislacionin e saj të brendshëm lidhur me të.

***Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse*** (Neni 25 i MP) - Neni 25 përcakton kushtet, masat dhe procedurat që ndiqen në raste të çrregullimeve serioze të tregut nga aplikimi i Marrëveshjes së Përkohshme. Palët bien dakord që të zbatojnë dispozitat e Nenit XIX të GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse. *Shih Box. Nr. 5 për dispozitat e plota të kësaj klauzole.*

## BOX nr. 5

### **Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse**

#### **Neni 25 i MP**

*1. Dispozitat e Nenit XIX GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse zbatohen ndërmjet palëve.*

*2. Kur cilido produkt i njërës Palë që importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë:*

*- dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurrese në territorin e Palës importuese; ose*

*- çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese,*

*Pala importuese mund të marrë masat e përshtatshme sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë nen.*

*3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të kapërcejnë nivelin e nevojshëm për riparimin e vështirësive që kanë lindur dhe normalisht duhet të konsistojnë në pezullimin e reduktimit të mëtejshëm të çdo norme tarifore për të aplikueshëm të parashikuar në këtë Marrëveshje për produktin përkatës, ose në rritjen e çdo norme tarifore për atë produkt deri në një kufi maksimal që i korrespondon normës tarifore të statusit të Kombit Më Të Favorizuar të aplikueshme për të njëjtin produkt. Masa të tilla përmbajnë elementë të qartë që sjellin në mënyrë progresive eliminimin e tyre në fund të periudhës së vendosur, si afat përfundimtar, dhe nuk merren për një periudhë më të gjatë se një vit. Në rrethana shumë të jashtëzakonshme mund të merren masa maksimumi deri në një periudhë prej deri në tre vjet. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë për një periudhë të paktën prej tre vjetësh që nga skadimi i masës.*

*4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin e përshtatshëm, për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.*

*5. Për zbatimin e paragrafëve të mësipërm aplikohen dispozitat e mëposhtme:*

*(a) Vështirësitë që lindin nga situata e përmendur në këtë nen i kalohen për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre vështirësive.*

*Në rast se Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose Pala eksportuese, brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre vështirësive, ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse u duhet dhënë përparësi*

*atyre që ndikojnë më pak negative në funksionimin e rregullimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me Nenin XIX GATT dhe Marrëveshjen e OBT-së për Masat Mbrojtëse ruajnë nivelin/hapësirën e preferencave të ofruara në këtë Marrëveshje.*

*(b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikojë menjëherë masa të përkohshme të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informon njëherësh Palën tjetër për këtë.*

*Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe u nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti me qëllim për të përcaktuar një kalendar veprimesh për heqjen e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.*

*6. Në rast se Komuniteti ose Shqipëria ia nënshtrohet importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, informon Palën tjetër.*

***Klauzola e pamjaftueshmërisë*** (Neni 26 i MP) - Në rastet kur zbatim i dispozitave të MP për lëvizjen e lirë të mallrave (Titulli II i MP) mund të shkaktojë mungesa produktesh apo vështirësi të tjera për palën eksportuese klauzola e nenit 26 lejon marrjen e masave të përshtatshme për tejkalimin e vështirësive. Marrja e këtyre masave duhet të plotësojë një sërë kushtesh (të specifikuar në këtë nen) ndër të cilët: 1) prioritet duhet të kenë masat që ndikojnë më pak negativisht në zbatimin e MP; 2) për këto masa duhet të njoftohet paraprakisht (ose sapo të jetë e mundur) Këshilli i SA në mënyrë që të kërkohet një zgjidhje e pranueshme; 3) Në rrethana të jashtëzakonshme që kërkojnë veprime të menjëhershme, palët duhet të konsultohen në Këshillin e SA për të përcaktuar një kalendar veprimesh për heqjen e tyre sapo ta lejojnë rrethanat. *Për kushtet e plota të aplikimit të klauzolës së pamjaftueshmërisë shih Nenin 26 të MP.*

***Monopolet shtetërore*** (Neni 27 i MP) - Duke pasur parasysh se konkurrenca e lirë është e papajtueshme me ekzistencën e monopoleve shtetërore neni 27 i MP përcakton qartë detyrime e Shqipërisë në këtë kontekst në mënyrë që të sigurojë një treg të hapur - " *Shqipëria do të*

*përshatë në mënyrë progresive të gjitha monopolet shtetërore me karakter tregtar për të siguruar që nga fundi i vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos ekzistojnë diskriminime ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë lidhur me kushtet sipas të cilave sigurohen dhe tregtohen mallrat. Këshilli i Stabilizim-Asociimit informohet për masat e miratuara për arritjen e këtij objekti".*

**Kufizimet e autorizuara** (Neni 29 i MP) - Nisur edhe nga praktikat ligjore të Komunitetit palët kanë rënë dakord për disa kufizime të një karakteri specifik në tregtinë mes tyre që kanë të bëjnë me mallra, tregtia apo tranziti i të cilave bie ndesh me: normat e moralit publik; sigurisë publike; politikave publike; mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve apo bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Sidoqoftë, këto kufizime nuk mund të bëhen mjete të diskriminimit arbitrar.

**Bashkëpunimi administrativ** (Neni 30 dhe 31 i MP) - Një nga aspektet më të rëndësishme të zbatimit të MP dhe luftës kundër parregullsive e mashtrimit në dogana është bashkëpunimi administrativ mes palëve. Neni 30 i MP i jep të drejtën palës që konstaton mungesë bashkëpunimi nga pala tjetër të pezullojë përkohësisht regjimin privilegjues të produkteve në përputhje me kushtet dhe dispozitat e këtij neni i cili në pikën 3 të tij specifikon disa prej rrethanave që nënkuptojnë mungesë bashkëpunimi administrativ. Në raste të tilla do të jetë Komiteti i Stabilizim Asociimit organi tek i cili palët do të synojnë gjetjen e zgjidhjes. Në mënyrë që të shmangen mosmarrëveshjet me operatorët ekonomikë (importuesit) në rastet e pezullimit të përkohshëm, pala duhet të publikojë në fletoren e vet zyrtare këtë pezullim. Gjithashtu, gabime të ndryshme lidhur me aplikimin e regjimit preferencial nga njëra palë mund të shkaktojnë pasoja tek pala tjetër. Në lidhje me gabime të kësaj natyre dhe pasojave të tyre do të jetë Këshilli i SA ai që shqyrton mundësi për miratimin e masave të nevojshme për zgjidhjen e situatës (Neni 31 i MP).

Në eksperiencën e deritanishme, gabime të tilla administrative në zbatimin e regjimit preferencial në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave të Protokollit 4 të MP mbi rregullat e origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrative. Duke pasyr parasys

rëndësinë e këtyre rregullave për vetë aplikimin e Marrëveshjes pjesa vijuese fokusohet ekskluzivisht në këtë aspekt.<sup>20</sup>

## IV.6. Rregullat e origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ

Në bazë të Nenit 28 të Marrëveshjes së Përkohshme, Protokollit 4 i saj përcakton rregullat e origjinës në lidhje me zbatimin e dispozitave të MP e posaçërisht të Titullit II të marrëveshjes përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në të. Origjina e produkteve është një nga elementët kryesorë të marrëveshjeve të tregtisë së lirë pasi në bazë të tyre bëhet ndarja e produkteve të palëve - nën regjim reciprok preferencial, nga produktet e palëve të treta (jashtë këtij regjimi). Edhe Marrëveshja e Përkohshme midis Shqipërisë dhe Komunitetit përmban dispozita të veçanta për këto rregulla të cilat përcaktojnë produktet që janë objekt i shfrytëzimit të regjimit preferencial dhe të kuotave përkatëse.

Protokollit 4 i MP përbëhet nga 38 nene (të ndara në 8 tituj), 3 shtojca dhe dy deklarata ndaj këtij protokollit. *Shih Box nr. 5.*

### BOX nr. 5

#### ***Pasqyra e lëndës e Protokollit 4***

Titulli I - Dispozita të përgjithshme

- *Neni 1 Përkufizime*

Titulli II - Përkufizimi i konceptit "Produkte Origjinuese"

- *Neni 2 Kërkesa të përgjithëshme*

- *Neni 3 Kumulimet dypalëshe ne Komunitet*

- *Neni 4 Kumulimi dypalësh ne Shqipëri*

- *Neni 5 Produktet tërësisht të përfituara*

- *Neni 6 Produkte të punuara mjaftueshëm ose të përpunuara*

<sup>20</sup> Titulli II i MP ka edhe 2 nene të tjera të cilët nuk u përmendën në këtë pjesë - Neni 23 dhe Neni 32 i MP. Marrëveshja e Përkohshme në Nenin 23 flet për përputhshmërinë e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë dhe rregullimeve tregtare me dispozitat e saj. Palët do të zhvillojnë konsultime në Këshillin e SA në lidhje me këto nisma dhe çështje të tjera në lidhje me politikën e tregtisë me vendet e treta në mënyrë që të pasqyrohen interesat e ndërsjellta të tyre. Neni 32 përcakton zbatimin e MP pa cënuar aplikimin e dispozitave të së drejtës Komunitare për Ishujt Kanarie.

- Neni 7 Punime ose operacione të pamjaftueshme
- Neni 8 Njësia e kualifikimit
- Neni 9 Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat
- Neni 10 Setet, kompletet
- Neni 11 Elementët neutrale

#### Titulli III - Kërkesat territoriale

- Neni 12 Parimet e territorialitetit
- Neni 13 Transporti direkt
- Neni 14 Ekspozitat

#### Titulli IV - Tërheqja ose përjashtimi

- Neni 15 Ndalimi i tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga, tarifat doganore

#### Titulli V - Vërtetimi i origjinës

- Neni 16 Kërkesa të përgjithëshme
  - Neni 17 Procedurat për lëshimin e certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR. 1
  - Neni 18 Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar a posteriori
  - Neni 19 Lëshimi i dublikates të certifikatës të qarkullimit të mallrave EUR. 1
  - Neni 20 Lëshimi i certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës të lëshuar apo bërë më parë
  - Neni 21 Kushtet për prodhimin e një deklarate fature
  - Neni 22 Eksportuesi i aprovuar
  - Neni 23 Vlefshmëria e deklaratës së origjinës
  - Neni 24 Depozitimi i deklaratës së origjinës
  - Neni 25 Importimet me dergesë të parë
  - Neni 26 Përjashtimet nga deklarata e origjinës
  - Neni 27 Dokumentat mbështetëse
  - Neni 28 Ruajtja e deklaratës së origjinës dhe e dokumentave mbështetëse
  - Neni 29 Mospërputhjet dhe gabimet formale
  - Neni 30 Shumat e shprehura ne Euro
- #### Titulli VI - Rregullimet për bashkëpunim administrativ
- Neni 31 Asistenca e përbashkët
  - Neni 32 Verifikimi i vërtetësive të origjinës
  - Neni 33 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
  - Neni 34 Penalitetet
  - Neni 35 Zonat e lira

Titulli VII - CEUTA dhe MELILLA

- *Neni 36 Zbatueshmeria e protokollit*

- *Neni 37 Kushtet specifike*


Titulli VIII - Dispozitat përfundimtare

- *Neni 38 Amendamentet e Protokollit*

Titulli II i Protokollit 4 të MP përcakton kërkesat e përgjithshme si edhe kushtet e veçanta që produktet objekt i MP duhet të përmbushin për tu kategorizuar si produkte origjinuese dhe rrjedhimisht të përfitojnë nga regjimi preferencial i MP.<sup>21</sup> Ndërkohë që për produktet origjinuese / tërësisht të prodhuara në territorin e palëve (Neni 2 dhe 5 i Protokollit 4) aplikimi i dispozitave të MP është i thjeshtë, situata ndërlikohet disi në lidhje me produktet e përpunuara të cilat kalojnë nëpërmjet operacioneve të ndryshme duke “përfshirë një vlerë të shtuar” edhe nga produkte të tjera me tjetër origjinë. Disa prej këtyre situatave janë:

***Kumulimet dypalëshe*** (Neni 3 i Protokollit 4) - Me anë të konceptit të kumulimit dypalësh zgjerohet koncepti i produkteve origjinuese në rastet kur proceset e përpunimit tejkalojnë operacionet minimale. Nëse përpunimi ngelet brenda kuadrit të proceseve përpunuese minimale (si larja, pastrimi, hekurosja, qërimi i frutave, therja e kafshëve etj.) atëherë nuk kemi të bëjmë me kumulim e si rrjedhojë do të aplikohen dispozitat për produktin bazë (për vendin nga i cili ai e ka origjinën). Në bazë të kësaj dispozite “materiale origjinuese në Shqipëri (Komunitet) do të konsiderohen si materiale origjinuese në Komunitet (Shqipëri) kur përfshihen në një produkt të përftuar atje.

***Produkte të punuara mjaftueshëm ose të përpunuara*** (Neni 6 i Protokollit 4) - Në rastet kur produktet jo-origjinuese kalojnë në procese të ndryshme për/punimi (në territorin e palëve) ato duhet të përmbushin disa kushte në mënyrë që të konsiderohen si produkte origjinuese. Këto kushte përcaktohen në mënyrë specifike për produktet e veçanta në Shtojcën II të Protokollit 4.<sup>22</sup> Siç tregon edhe vetë titulli i shtojcës palët (Shqipëria dhe Komuniteti) kanë rënë dakord për një listë operacionesh të përpunimit ose proceseve që kërkohet

 <sup>21</sup> Neni 8 i Protokollit 4: “Njësia e Kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij Protokollit do të jetë produkti i veçantë i cili konsiderohet si njësi bazë kur për përcaktimin e klasifikimit përdoret nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar”.

<sup>22</sup> Në Shtojcën I (Shënime Prezantuese të Listës në Shtojcën II) të këtij protokollit jepen disa shpjegime dhe udhëzime në lidhje me listën e Shtojcës II të Protokollit 4 (Shtojca II - Lista e operacioneve të përpunimit ose proceseve që kërkohet t’i nënshtrohen mallrat io-origjinuese, në mënyrë që produkti përfundimtar të përfitojë statusin e origjinës).

t'i nënshtrohen mallrat jo-origjinuese, në mënyrë që produkti përfundimtar të përfitojë statusin e produktit të origjinës. Lista e kësaj shtojce - e dhënë në 3 kolona ku kolona e fundit përmban 2 nënkolona - përmban kodin e produktit (kolona e parë), përshkrimin e tij (kolona e dytë) dhe në kolonën e tretë jepet një përshkrim i punimit ose përpunimit të kryer mbi materialet jo origjinuese i cili u jep statusin e origjinës (në 2 nënkolona). Për produktet të cilat nuk janë përfshirë në Shtojcën II megjithatë do të duhet të konsultohen pjesët e tjera të Marrëveshjes së Përkohshme.

## BOX nr. 6

*Nje shoqeri me qender dhe fabrike ne Gjermani ka prodhuar nje motorr me piston djegje te brendshme me levizje te ndersjellte (motor klasik automjeti). Per prodhimin e ketij motori jane perdorur edhe materiale me origjine nga Rusia. Vlera e ketyre materialeve eshte 30 % e cmimit exwork te motorrit. Ky produkt do te konsiderohet me origjine gjermane pasi sipas parashikimit te kreut 8407 te shtojces nr.2 te Protokollit 4 te marreveshjejes vlera e materialeve jo origjinues te perdorur nuk duhet te kaloje 40 % te cmimit exwork te produktit.*

***Punime ose operacione të pamjaftueshme*** (Neni 7 i Protokollit 4) - Objekt i kësaj dispozite janë situata e parashtruara në Nenin 6 të Protokollit 4, por duke përcaktuar për/punimet që kryhen në produktet jo-origjinuese të cilat konsiderohen si të pamjaftueshme për tu dhënë atyre statusin e produkteve origjinuese. Këto punime ose përpunime presupozohet se nuk bëjnë ndryshime të tilla rrënjësore të produktit final sa për t'i ndryshuar atij statusin e origjinës dhe rrjedhimisht edhe regjimin e tregtimit të tij mes palëve të MP. Disa prej ndërhyrjeve të tilla janë: kryerja e operacioneve për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit; thyerjet dhe bashkimet e paketimeve; hekurosja ose presimi i tekstileve; operacionet e thjeshta të lyerjeve apo shkëlqimit; operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit; ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta; fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove si dhe i shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre etj. (për listën e plotë të tyre shih Neni 7 pika 1 i Protokollit 4 të MP).

## BOX nr. 7

*Shoqeria AA është një shoqëri shqiptare që ka për objekt prodhimin dhe tregtimin e cantave. Sipas modeleve të cantave të stiluara nëpër saj, ajo ka lidhur një kontratë me një shoqëri egjiptiane dhe një kontratë me një shoqëri kineze. Shoqëria egjiptiane e furnizon shoqërinë shqiptare me pjesë lekure për prodhimin e cantave, ndërsa shoqëria kineze e furnizon me pjesët plastike që nevojiten për prodhimin e këtyre cantave. Shoqëria shqiptare, ben qepjen e këtyre cantave, paketimin e tyre dhe meqenëse janë stiluar nëpër saj, vendosë pikerisht marken që ka zgjedhur ajo.*

*Produktin e saj shoqëria shqiptare e eksporton në Itali dhe me qëllim për të përfituar nga marrëshja e paraqet si produkt shqiptar. Autoritetet doganore shqiptare dhe me pas ata italiane kanë refuzuar të aplikojnë dispozitat favorizuese të marrëveshjes duke referuar nenit 7 të Protokollit 4, pasi bashkimi i thjeshtë i pjesëve, paketimi dhe vendosja e etiketave janë përcaktuar si operacione të pamjaftueshme për t'i dhënë produktit statusin e origjinës.*

Në bazë të këtij Protokollit aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat të lidhura me një pjesë pajisjeje, makine, aparati apo mjeti, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose nuk janë të ndara dukshëm në faturë, do të konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit në fjalë. Gjithashtu, në përcaktimin e origjinës së produkteve nuk mund të merren parasysh elementë të tillë (neutralë) si energjia elektrike dhe karburanti; toka dhe pajisjet; makineritë dhe veglat; mallrat të cilat nuk hyjnë dhe të cilat nuk synohen të përfshihen në përbërjen finale të produktit. Në rastet kur kemi të bëjmë me të ashtuquajturat "komplete", në bazë të Neni 10 të protokollit 4, ato do të konsiderohen si origjinuese kur të gjithë produktet përbërës janë origjinuese. Kur këto komplete përbëhen nga produkte origjinuese dhe jo origjinuese, kompleti do të konsiderohet si origjinuese vetëm nëse vlera e produkteve jo origjinuese të mos kalojë 15% të çmimit "ex work" të kompletit.

Përveç Titullit II të përshkruar më sipër, dhe Titujve III dhe IV të Protokollit 4 që përcaktojnë rregulla që kanë të bëjnë me kërkesat territoriale (III) dhe sanksionojnë ndalimin e tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga tarifrat doganore, një pjesë tjetër mjaft e

rëndësishme e këtij protokollit është Titulli V i tij - **Vërtetimi i Origjinës**.<sup>23</sup>


Në bazë të MP produktet origjinuese do të përfitojnë nga regjimi preferencial i Marrëveshje së Përkohshme me paraqitjen e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 ose, në rastet e specifikuar në Nenin 21(1) të Protokollit 4 të MP, me paraqitjen e një deklarate - deklarata e faturës - e cila lëshohet nga eksportuesi sipas dispozitave të këtij neni. Certifikata e lëvizjes EUR 1 lëshohet nga Autoritetet Doganore të vendit eksportues sipas aplikimit të bërë me shkrim nga eksportuesi, ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar (Neni 17 - 20 i Protokollit 4 të MP). Titulli V i Protokollit 4 përcakton gjithashtu edhe rregullat dhe procedurat në lidhje me këto dokumente si edhe me vërtetimin e origjinës dhe dokumentacionit mbështetës.

Përjashtimet nga detyrimi për të dokumentuar origjinën e produkteve përcaktohen në mënyrë taksative në Nenin 26 të Protokollit 4 të MP dhe ato përfshijnë:

- Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privat tek personat privat ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve nëse ato nuk importohen për qëllime tregtie.
- Importet të cilat janë të rastësishme (pjesë e bagazheve personale të udhëtareve) dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga nëse nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.

Vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojnë 500 Euro në rastin e pakove të vogla ose 1 200 Euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve.

Bashkëpunimi dhe asistenca reciproke midis autoriteteve doganore të palëve të MP është mjaft e rëndësishme për zbatimin rigoroz të dispozitave të Protokollit 4. Titulli VI i Protokollit 4 të MP përcakton kuadrin e këtij bashkëpunimi (Neni 31 dhe 32) - të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontekst - ndërsa në bazë të Nenit 33 autorizohet Komiteti i Stabilizim Asocimit si organi kompetent ku palët do të drejtohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme në lidhje me zbatimin e Nenit 32 të Protokollit 4 (Verifikimi i vërtetimit të origjinës) ose që kanë të bëjnë me interpretimin e këtij protokollit.<sup>24</sup> Këto organe duhet të kenë parasysh veçanërisht rregullat dhe

 <sup>23</sup> Shtojca III e Protokollit 4 të MP përmban modelet për certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe aplikimi për certifikatë lëvizjeje EUR.1

<sup>24</sup> Këshilli i Stabilizim Asocimit nga ana tjetër është i autorizuar të bëjë mendime ndaj Protokollit 4 të MP.

shpjegimet e dhëna në Shtojcat I dhe II të Protokollit 4 të MP dhe dispozitat e tij. Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues duhet të respektojnë legjislacionin e vendit importues.

Në Titullin VII të Protokollit 4 palët kanë rënë dakord për rregulla që rregullojnë zbatueshmërinë e Protokollit për enklavat spanjolle Ceuta dhe Melilla. Edhe pse këto zona nuk janë pjesë e bashkimit doganor të BE me anë të Protokollit 2 të Aktit të Anëtarësimit të Spanjës në Komunitet Ceuta dhe Melilla përfitojnë nga një marrëveshje autonome preferenciale me KE çka u lejon produkteve të prodhuara në këto dy qytete të përfitojnë nga një pjesë e mirë e sistemeve kumulative që KE nënshkruan me vendet e treta. Rregullat preferenciale për origjinën e produkteve nga Ceuta dhe Melilla janë sanksionuar me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 82/2001 (datë 5 Dhjetor 2000).

Gjithashtu, me anë të dy deklaratave në lidhje me Protokollin 4 Shqipëria zotohet të aplikojë MP - posaçërisht, rregullat e origjinës - për produktet që e kanë origjinën nga Principata e Andorës (për Kapitujt 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar) dhe Republika e San Marinos.<sup>25</sup>

Në Titullin III të saj Marrëveshja e Përkohshme përfshin edhe disa dispozita të tjera për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar ndërkohë që në Protokollin 5 të MP palët kanë përcaktuar kuadrin e plotë mbi ndihmën e ndërsjelltë administrative në çështjet doganore. Këto dispozita do të trajtohen më gjerësisht në pjesën vijuese të këtij botimi.

<sup>25</sup> Neni 32 i Marrëveshjes së Përkohshme gjithashtu ka një dispozitë të veçantë edhe për Ishujt Kanarie, por e cila ka të bëjë me zbatimin e gjithë MP (jo thjesht zbatimin e Protokollit 4 të saj).

## V.

# Dispozita të tjera për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar

Përveç dispozitave të cilat rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë regjimin (reciprok) preferencial të tregtisë, lëvizja e lirë e mallrave në tregun e palëve nënshkruese presupozon gjithashtu edhe mirëfunksionimin dhe zbatimin rigoroz të disa rregullave thelbësore për një ekonomi të hapur tregu dhe mekanizmave të saj rregullues. Disa prej tyre përfshijnë konkurrencën e lirë, respektimi i të drejtave dhe pronës, thjeshtëzim i procedurave të bashkëpunimit, ndalim i diskriminimit etj. Këto dhe të tjera dispozita sanksionohen në Titullin III të Marrëveshjes së Përkohshme si edhe në Protokollin 5<sup>26</sup> (mbi Ndhimën e ndërsjelltë administrative në çështjet doganore) dhe Shtojcën IV (mbi Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare) ndaj MP.

Titulli III i MP trajton 5 çështje ose aspekte të tregtisë së lirë të cilat lidhen ngushtë me marrëdhëniet tregtare midis palëve dhe kjo: Trafiku tranzit; Konkurrenca dhe ndihma shtetërore; Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare; Doganat; dhe Kontratat publike.

**Trafiku Tranzit** (Neni 33 - 36 i MP) - Një pjesë e madhe e dispozitave të MP që kanë të bëjnë me trafikun tranzit janë pjesë e Protokollit 5 të MSA i cili përveç këtyre dispozitave nuk përfshihet në Marrëveshjen e Përkohshme. Në bazë të MP palët bien dakord t'i japin akses të pakufizuar trafikut të tranzitit të njëra-tjetrës nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme. Sipas Nenit 33 të MP me trafik i transitit nënkuptohet:

- *Trafik i tranzitit të Komunitetit*: transporti, nga një transportues i vendosur në Komunitet, i mallrave në tranzit nëpërmjet territorit shqiptar në rrugën drejt ose nga një Shtet Anëtar i Komunitetit;

<sup>26</sup> Në renditjen e protokolleve në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit Protokollit 5 i MP është Protokollit 6 i MSA. Ky sqarim bëhet për të shmangur keqkuptimet në tekstin e mëposhtëm pasi MP përfshin edhe disa dispozita të Protokollit 5 të MSA (nuk është pjesë e MP).

- *Trafiku i tranzitit shqiptar*: transporti, nga një transportues i vendosur në Shqipëri, i mallrave në tranzit nga Shqipëria nëpërmjet territorit të Komunitetit dhe të destinuara për një vend të tretë, ose i mallrave nga një vend i tretë të destinuara për Shqipërinë.

Palët gjithashtu angazhohen të thjeshtojnë formalitetet në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e lirë e mallrave bilaterale ose tranzit. Bashkëpunimi për këto aspekte si edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me to do të bëhet në kuadër të Komisionit të Përbashkët i cili do të koordinojë gjithashtu edhe monitorimin, parashikimet dhe punët e tjera statistikore që kanë lidhje me transportin ndërkombëtar dhe trafikun tranzit në veçanti. Pavarësisht se palët angazhohen për zbatim rigoroz të këtyre dispozitave Marrëveshja megjithatë parashikon edhe disa kushte të veçanta nën të cilat palët mund të marrin masa kufizuese të trafikut (Neni 33(3) dhe Neni 35 i MP) por gjithmonë duke zbatuar parimin e mos-diskriminimit dhe në respekt të plotë të detyrimeve për të bashkëpunuar dhe për të gjetur zgjidhje ndaj situatave të ngjashme.

**Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike** (Neni 37 dhe 38 i MP) - Ashtu siç u përmend edhe më sipër në tekst (*shih "Struktura dhe Natyra e Marrëveshjes së Përkohshme"*) Marrëveshja e Përkohshme nuk ka të bëjë thjesht me tarifatat doganore, kuotat dhe lëvizjen e lirë por ajo përfshin edhe instrumente të tjerë mjaft të rëndësishëm për mirëfunksionimin e një zone të lirë tregtie. Për këtë arsye palët e Marrëveshjes së Përkohshme kanë rënë dakord për respektimin e disa parimeve bazë të funksionimit të ekonomisë së tregut, duke njohur kështu rëndësinë e respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut, parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, të zbatimit të ligjit, ekonomisë së tregut, bashkëpunimit rajonal etj. Konkurrenca e lirë, mos-diskriminimi dhe roli rregullues por jo *zhbalancues* i shtetit janë disa prej këtyre parimeve të cilat sigurojnë mirëfunksionimin e bashkëpunimit tregtar dhe aplikimin e drejtë të MP. Neni 37 i Marrëveshjes i obligon palët të mos lejojnë praktikën (marrëveshje mes operatorëve ekonomikë) që dëmtojnë konkurrencën e lirë, abuzimin me pozicionin dominues apo ndihmat shtetërore që favorizojnë sipërmarrje ose produkte të caktuara në dëm të konkurrencës. Praktika të tilla përbëjnë në fakt pjesën më të madhe të rasteve që paraqiten para Gjykatës Europiane të Drejtësisë. Kriteret me anë të të cilave do të vlerësohen këto praktika në dëm të konkurrencës në rastin e MP janë ato që janë përcaktuar në Traktatin themelues të KE, përkatësisht nenet 81, 82, 86 dhe 87 të tij

çka do të thotë se kjo pjesë e *acquis communautaire* duhet të merret parasysh nga Shqipëria.<sup>27</sup> Sidoqoftë, palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se ajo konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian. Kjo dispozitë e Traktatit të KE (Neni 87/3/a) lejon dhënien e ndihmës shtetërore e cila jepet “për të promovuar zhvillimin ekonomik të *zonave me standard jetesë shumë të ulët ose zonave me nivele mjaft të ulëta të punësimit*”.

Në lidhje me ato sipërmarrje publike të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive në Shqipëri - ndërmarrje që ofrojnë shërbime të një interesi të përgjithshëm publik - brenda vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të MP Shqipëria do të fillojë të zbatojë parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Europian, duke iu referuar veçanërisht nenit 86. Shih Box nr. 8.


## BOX Nr. 8

### **Neni 86 i Traktatit të KE**

“Në rastin e sipërmarrjeve publike dhe sipërmarrjeve të cilave Shtetet Anëtare u akordojnë të drejta të veçanta ose ekskluzive, Shtetet Anëtare nuk do të miratojnë dhe as do të mbajnë në fuqi masa në kundërshtim me rregullat që përmban ky Traktat, veçanërisht në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Nenin 12 dhe Nenet 81 deri 89.

Sipërmarrjet e autorizuara për kryerjen e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm ose që kanë karakterin e monopoleve fitim-prodhuese do t’i nënshtrohen rregullave që përmbahen në këtë Traktat, në veçanti rregullave për konkurrencën, për sa kohë që aplikimi i këtyre rregullave nuk pengon performancën, ligjërisht ose faktikisht, e detyrave të veçanta që u janë caktuar. Zhvillimi i tregëtisë nuk duhet të ndikohet në një masë të tillë që të shkojë kundër interesave të Komunitetit.

**Komisioni do të sigurojë aplikimin e dispozitave të këtij Neni dhe, kur është e nevojshme, do t’u adresojë Shteteve Anëtare direktivat ose vendimet e duhura.”**

 <sup>27</sup> Për informacion më të detajuar mbi këto praktika dhe instrumentet interpretues të adoptuara nga institucionet e Komunitetit shih [http://ec.europa.eu/comm/competition/index\\_en.html](http://ec.europa.eu/comm/competition/index_en.html).

Brenda katër vjetësh nga hyrja në fuqi e MP Shqipëria do të ngrejë një institucion publik dhe funksionalisht të pavarur për të monitoruar dhe luftuar këto praktika si edhe një institucion të pavarur me kompetenca kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me Nenin 37 të MP dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme. Ashtu si edhe autoriteti i konkurrencës edhe institucioni që do të monitorojë ndihmat shtetërore do të ngrihet brenda katër vitesh prej hyrjes në fuqi të MP. Në lidhje me ndihmat shtetërore palët duhet të tregojnë transparencë të plotë (Neni 37 pika 5 dhe 6 e MP) për ndihmat e dhëna. Shqipëria dhe Komuniteti mund të marrin masat e nevojshme në rastet kur konstatojnë tek pala tjetër praktika që dëmtojnë konkurrencën, por pasi të kenë kryer paraprakisht konsultime me Këshillin e Stabilizim-Asocimit. Këto dispozita nuk i pengojnë palët të marrin masa antidumping ose të masave kundërvepruese për sa kohë që ato janë në përputhje me nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

## BOX nr. 9 - Kazus i kombinuar.

*Shoqëria A është një shoqëri tregtare me qendër në Itali. Ajo prodhon veshje të ndryshme kryesisht fustane dhe veshje për femra. Në janar 2007 kjo shoqëri ka marrë pjesë në një panair të zhvilluar në shtet tjetër (të ndryshëm nga Komuniteti ose Shqipëria) ku ka reklamuar produktet e saj. Gjatë ditëve të ekspozimit, administratorët e shoqërisë A janë futur në tratativa tregtare me përfaqësues të shoqërisë B, e cila është një shoqëri tregtare me qendër në Shqipëri. Shoqëria A I ka propozuar shoqërisë B që t'i shesë të gjithë pantallonat e modelit "trendy" të prodhuara prej saj dhe të ekspozuar nga modelet në panair. Një ditë më vonë, shoqëria B I propozon shoqërisë A që të reklamonte një kombinim të pantallonave "trendy" me bluzat e modeli "klasik" dhe me pas të kthente një pergjigje për marrëveshjen.*

*Shoqëria A e pranon propozimin dhe vendos që në sfilatën e radhës të reklamojë bluzat "klasik" në të njëjtat topmodele me pantallonat "trendy". Për këtë qëllim shoqëria A kontraktonte një shoqëri vendase për të bërë pershtatjet e nevojshme që të dy produktet të jenë të masave të njëjta dhe të mund të reklamohen nga të njëjtat*

*topmodelet. Pas kesaj sfilate, shoqeria A dhe shoqeria B lidhin nje kontrate shitjeje me ane te te ciles bien dakort qe shoqeria A t'i shese shoqerise B si pantallonat edhe bluzat. Me qellim ekzekutimin e kesaj kontrate, shoqeria B kontrakton nje shoqeri vendase qe pas perfundimit te panairit te mundesoje larjen, paketimin e pantallonave dhe bluzave sic ishin reklamuar nga modelet dhe ruajtjen e tyre derisa shoqeria B te mund te ti transportoje per ne Shqiperi.*

*Ne momentin qe ky product paraqitet para autoriteteve doganore shqiptare, ato refuzojne te njohin statusin e produktit te prodhuar ne Itali duke arsyetuar se shoqeria A ka eksportuar ne vendin ku eshte zhvilluar ekspozita nje product te ndryshem nga produkti qe po importon shoqeria B nga shteti ku eshte zhvilluar ekspozita. Neni 14 I Protokollit 4 nuk lejon nje hapesire per perfitim te tille. Shoqeria B I drejtohet Gjykates duke kerkuar qe ne kete rast te aplikohen parashikimet e "Marreveshjes se Perkoheshme ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Komunitetit European per tregetine dhe bashkepunimin tregtar". Ne vendimin e saj Gjykata arsyeton se nenet e marreveshjes nuk mund te interpretohen te vecuar nga njeri tjetri. Keshtu, neni 14 I Protokollit 4 ka si qellim pikerisht mbrojtjen e interesave te eksportuesve apo importuesve te shqiptar apo komunitar. Shoqeria A ka eksportuar prodhimet e saj vetem me qellim ekspozimi dhe gjate ketij ekspozimi I jane shitur shoqerise B. Parashikimet e nenit 7 te ketij protokolli duhet te respektohen edhe ne rastin konkret duke I konsideruar operacionet e kryera ne vendin e ndryshem nga Shqiperia apo Komuniteti te pamjaftueshme per te ndryshuar statusin e produktit te origjines. Operacione te tilla si bashkimi I thjeshte I pjeseve apo paketime si edhe pershtatja e permasave thjeshte me qellim ekspozimi nuk mund te ndryshojne statusin e origjines se produktit te prodhuar ne Shqiperi apo nje vend Komunitar, pasi edhe produktet e prodhuara nga nje shtet tjetet, ne baze te nenit 7 te protokollit, nuk mund te marrin statusin e produktit te origjines nqs ne Shqiperi apo Komunitet do te kryenin te njejtat operacione. Ne interpretimin e saj, Gjykata I referohet edhe nenit 10 te Protokollit 4 duke arsyetuar se produkti I importuar nga shoqeria B eshte nje komplet, I cili perbehet nga produkte me origjine nga nje shtet Komunitar.*

***Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare*** (Neni 39 i MP dhe Shtojca IV e MP) - Sigurimi i mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare përbën një nga aspektet me mjaft rëndësi të ekonomisë së hapur pasi abuzimi me to ka ndikim të drejtpërdrejtë në konkurrencën midis operatorëve ekonomikë. Marrëveshja e Përkohshme e detyron Shqipërinë të sigurojë një nivel mbrojtjeje të këtyre të drejtave të njëjtë me atë të Komunitetit brenda një periudhe kohore prej 4 vitesh nga hyrja në fuqi e MP. Brenda këtij afati kohor (4 vjeçar) Shqipëria është angazhuar gjithashtu të bëhet palë në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, lista e plotë e të cilave jepet në Shtojcën IV të Marrëveshjes së Përkohshme - Shtojca IV mbi të drejtat e autorësisë intelektuale, industriale dhe tregtare. Kjo përbën sigurisht edhe një sfidë për vendin veçanërisht nëse kemi parasysh raportin midis ekonomisë informate dhe asaj formale në vend.

***Kontratat Publike*** (Neni 40 i MP) - Prej datës 1 Dhjetor 2006 kur MP ka hyrë në fuqi kompanitë shqiptare kanë të drejtën të marrin pjesë për akordim kontrate në Komunitet sipas rregullave të prokurimit të Komunitetit dhe kjo në pozita të barabarta me kompanitë komunitare. Brenda një periudhe 4 vjeçare e njëjta e drejtë do tu njihet edhe kompanive komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri për kontrata publike në bazë të Ligjit shqiptar për Prokurimin Publik. Ndërkohë, për ato shoqëri komunitare që janë vendosur në Shqipëri kjo e drejtë fitohet me hyrjen në fuqi të MP (1 Dhjetor 2006) dhe trajtimi i tyre nuk mund të jetë më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive shqiptare.

***Doganat*** (Neni 41 dhe Protokollu 5 i MP mbi Ndhimën e ndërsjelltë administrative në çështjet doganore) - Bashkëpunimi mes palëve në çështjet doganore dhe përafrimi i sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për zbatimin e MP (e më vonë të MSA) por edhe për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* në fushën e doganave. Protokollu 5 i MP parashtron parimet dhe rregullat në kuadër të të cilave zhvillohet bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjelltë administrative mes palëve në çështjet doganore. Protokollu konsiston në 14 nene të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve si edhe procedurat e ndihmës së ndërsjelltë ndaj çdo autoriteti administrativ të palëve. Zbatimi i tij u është besuar autoriteteve doganore të Shqipërisë dhe shërbimeve

kompetente të Komisionit të Komuniteteve Europiane si edhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare. Ato do të vendosin në lidhje me të gjitha masat dhe rregullimet praktike të nevojshme për zbatimin e saj, ndërsa mund t'u rekomandojnë gjithashtu organeve kompetente mendime të cilat në gjykimin e tyre duhet të bëhen ndaj këtij Protokollit.

Objekt i kërkesës për ndihmë nga autoriteti kërkues është gjithë informacioni në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor duke përfshirë informacione në lidhje me aktivitetet e vërejtura ose të planifikuara që janë ose mund të jenë veprime në shkëlqje të legjislacionit doganor. Në pikat 2 dhe 3 të Neni 3 të Protokollit 5 të MP përcaktohen çështjet të cilat janë objekt i kërkesës për ndihmë ndërkohë që palët mund t'i ofrojnë asistencë njëra tjetrës me iniciativën e tyre (pra pa pasur kërkesë nga pala tjetër) në raste shkëlqesh të ndodhura ose të pritshme të legjislacionit doganor (Neni 4 i Protokollit 5). Në çdo rast, informacioni i marrë nëpërmjet ndihmës së ofruar nga pala tjetër duhet të ngelet konfidencial (ose i rezervuar) dhe do të mbrohet nga dispozitat ligjore përkatëse. Në pikën 4 të tij Neni 10 i Protokollit 5 përcakton shprehimisht se "informacioni i përfutur do të përdoret vetëm për qëllime të këtij Protokollit. Kur njëra prej Palëve Kontraktuese dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, ajo do të marrë miratim paraprak me shkrim nga autoriteti, i cili ka siguruar informacionin. Ky përdorim më pas do të jetë subjekt ndaj kufizimeve të parashtruara nga ai autoritet".

Procedura, përmbajtja dhe forma e plotë e kërkesës për ndihmë / përgjigjes ndaj kërkesës si edhe ekzekutimi i tyre specifikohen në dispozitat e neneve 5 - 8 të Protokollit 5 të MP. Në parim autoritetet e palëve janë të detyruara të ofrojnë ndihmë reciproke përveç rasteve kur (Neni 9 i protokollit):

- ka të ngjarë të cënohet sovranitetin e Shqipërisë ose ai të një Shteti Anëtar, të cilit i është kërkuar të sigurojë ndihmë sipas këtij protokollit;
- ka të ngjarë të cënojë politikën publike, sigurimin ose interesa të tjera thelbësore, veçanërisht në rastet e referuara sipas neni 10 pika 2 (në lidhje me të dhënat personale);
- shkelin një sekret industrial, tregtar ose profesional.

Dispozitat e Protokollit 5 të MP kanë precedencë mbi dispozitat e çdo marrëveshjeje dypalëshe për ndihmë të ndërsjelltë, që ka qenë ose

që mund të lidhet midis Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë, në rastet kur dispozitat e kësaj të fundit nuk janë në përputhje me ato të këtij Protokollit. Gjithashtu, dispozitat e tij do të çmohen si plotësuese ndaj marrëveshjeve për ndihmë të ndërsjelltë midis Shqipërisë dhe vendeve anëtare të KE. Në çdo rast, detyrimet e palëve që burojnë nga akte ndërkombëtare nuk mund të çënohen nga ky Protokoll.

# Marrëveshja e Përkohshme në kuadrin Ligjor dhe institucional të Shqipërisë

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Përkohshme përbën një hap të rëndësishëm të bashkëpunimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Duke qenë se pasojat e saj janë njëkohësisht politike, juridike dhe ekonomike është e domosdoshme njohja dhe komentimi i dispozitave nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë shqiptare. Juridikisht, në hierarkinë e akteve normative Marrëveshja qendron mbi legjislacionin vendas dhe duke qenë kështu ajo pasjell detyrimin për përshtatjen e këtij legjislacioni me parashikimet e marrëveshjes. Nga mënyra e formulimit dhe hollësite që ajo paraqet, marrëveshja mund të konsiderohet lehtësisht drejtpërdrejtë e zbatueshme sidomos për organet doganore dhe shoqëritë private që operojnë në Shqipëri si eksportues apo importues.

Zbatimi me korrektesë i dispozitave të kësaj marrëveshje kërkon që Shqipëria dhe Bashkimi Europian reciprokisht të përmbushin detyrimet e marra përsipër duke krijuar atë klimë të nevojshme ndërshtetërore për arritjen e qëllimeve politiko-ekonomike të marrëveshjes. Megjithatë në këtë botim fokusi u përqendrua edhe në efektin që marrëveshja do të sjellë në raportin organe shtetërore - subjekte private. Kështu domosdoshmërisht organet doganore dhe subjektet tregtare duhet të kenë të qarta dispozitat e kësaj marrëveshje dhe pasojat që ajo sjell në detyrimet që subjektet kanë ndaj shtetit. Duke qenë se organet shtetërore ushtrojnë funksionet e tyre në një procedurë të caktuar administrative, parashikimet e marrëveshjes në shumicën e tyre do të përbëjnë anën materiale dhe referencën ligjore të akteve administrative që të do të dalin nga organet doganore në ngarkim të subjekteve eksportuese apo importuese. Interpretimi i ndryshëm i marrëveshjes nga subjektet tregtare nga njëra anë dhe organeve shtetërore nga ana tjetër detyrimisht do të pasjellë konflikte. Është pikërisht ky këndvështrim që e bën të domosdoshme njohjen sa më mirë të marrëveshjes nga gjyqtarët, të cilat në mënyrë të pritshme do të duhet të zgjidhin çështje të caktuara duke interpretuar drejtpërdrejtë nenet e veçanta të kësaj marrëveshjeje. Ky botim në

mënyrë modeste i drejtohet pikërisht grupeve të interesuara me qëllimin e vetëm të sensibilizimit të tyre për efektet e pritshme të marrëveshjes dhe si një pikënisje të një debati juridiko-ekonomik për mënyrën sa më të efektshme të zbatimit të saj.

Megjithëse marrëveshja është e vetëzbatueshme është e nevojshme që legjislacioni doganor dhe tatimor të bëjë modifikimet e duhura në rastet kur midis parashikimeve të marrëveshjes dhe akteve të tjera ligjore apo nënligjore mund të ketë mospërthuthje (megjithëse aktualisht nuk janë konstatuar raste të tilla). Pikërisht në këtë moment marrëveshja obligon organet e nismave legjislative që të marrin hapat e duhur për përshtatjen e legjislacionit shqiptar me pikat e marrëveshjes. Ekzekutivi ka detyrimin që në varësi të situatave të konstatuara t'i kërkojë Kuvendit të Shqipërisë të ndërhyjë me ndryshime apo të miratojë kur është e nevojshme ligje të veçanta. Nga ana tjetër, për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, pushteti ekzekutiv mund të nxjerrë akte nënligjore me qëllim zbatimin sa më të mirë të marrëveshjes dhe udhëzimin e organeve në varësi të Këshillit të Ministrave për mënyrën e aplikimit të neneve të saj.

Për vetë efektet që passjell një marrëveshje apo ligj, zbatimi i saj ngarkon me detyrime dhe përgjegjësi organe të ndryshme. Sigurisht që nuk është e rastit të listohen të gjithë organet shtetërore që kjo marrëveshje ngarkon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, por fokusi duhet detyrimisht drejtuar në përgjegjësitë që kanë autoritetet doganore. Janë pikërisht Drejtoritë doganore me hallkat përkatëse të tyre, të cilat do të kontrollojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e parashikimeve të kësaj marrëveshjeje. Këto organe do të bëjnë verifikimet e duhura dhe kontrollin mbi subjektet eksportuese apo importuese. Njohja sa më e mirë e legjislacionit nga këto organe, aplikimi i praktikave të qarta dhe udhëzimeve konkrete, do të passjellë praktikisht efektet e marrëveshjes. Në varësi të piramidës së organeve doganore do të jenë të përcaktuara edhe detyrat konkrete të secilës hallkë dhe mënyra e kontrollit të tyre.

Paralelisht me organet doganore njohja e parashikimeve të marrëveshjes është domosdoshmëri edhe e subjekteve private që në veprimtarinë e tyre kanë si objekt eksportin apo importin e produkteve. Vetë marrëveshja ka si qëllim krijimin e një klime sa më favorizuese

për subjektet tregtare shqiptare dhe komunitare, por nga ana tjetër është detyrim i këtyre subjekteve që të mbajnë, ruajnë dhe të paraqesin dokumentacionin e duhur për të bërë të mundur përfitimin konkret të neneve të marrëveshjes.

Mënyra e sjelljes reciproke nga njëra anë e organeve doganore dhe nga ana tjetër e subjekteve private do të jetë përcaktuese në egzistencën apo jo të konflikteve apo qendrimeve të ndryshme. Mosnjohja korrekte e marrëveshjes apo keqintrepretimi i saj pashmangshmërisht do t'i detyrojë subjektet private dhe/ose organet doganore që të kërkojnë ndihmën e Gjykatës. Duke qenë kështu, njohja dhe komentimi i marrëveshjes si edhe (në një moment më të vonshëm) unifikimi i praktikave gjyqësore është jo vetëm detyrë e gjyqtarëve por edhe një sfidë që kërkon angazhimin e të gjithëve.

